

Evropa në 12 leksione

nga Paskal Fonten



Bashkimi Evropian



Këtë doracak dhe sqarimet tjera për BE-në mund t'i gjeni në faqen e internetit ec.europa.eu/publications/

Komisioni Evropian
Drejtoria e Përgjithshme për Komunikim
Publikime
B-1049 Bruksel

Dorëshkrimi është përfunduar në tetor të vitit 2006

Ilustrimi në ballinë dhe kapituj: Raportuesit

Luksemburg: Zyra për botime zyrtare të Bashkësive evropiane, 2006

ISBN 978-92-79-09690-7

DOI 10.2794/20543

Bashkësitë evropiane, 2006
Riprodhimi është i lejuar.

U botua në Kosovë*

*nën Rezolutën 1244/1999 të KSKB



Evropa në 12 leksione

nga Paskal Fonten,
ish asistenti i Zhan Monesë
dhe profesor në Institutin për Studime Politike në Paris





1.		Pse Bashkimi Evropian?	4
2.		Dhjetë hapat historikë	8
3.		Zgjerimi dhe politika fqinjësore	12
4.		Si funksionon BE-ja?	16
5.		Çfarë bën BE-ja?	22
6.		Tregu unik	28
7.		Unioni Ekonomik dhe Monetar (BEM) dhe euroja	32
8.		Drejt shoqërisë të bazuar në dituri	36
9.		Një Evropë e qytetarëve	40
10.		Liria, siguria dhe drejtësia	44
11.		Bashkimi Evropian në skenën botërore	48
12.		Cila është ardhmëria e Evropës?	54
		Datat kyçe në historinë e integritit evropian	58

1. Pse Bashkimi Evropian?





Misioni i Evropës në shekullin 21 është:

- të sigurojë paqe, prosperitet dhe stabilitet për popujt e saj;
- t'i tejkalojë ndarjet në kontinent;
- të sigurojë që qytetarët e saj të jetojnë në siguri;
- të promovojë zhvillim të balancuar ekonomik dhe social;
- të ballafaqohet me sfidat e globalizimit dhe ta ruajë llojllojshmërinë e popujve të Evropës;
- t'i ruajë vlerat e përbashkëta të evropianëve, siç janë zhvillimi i qëndrueshëm dhe mjedisi i shëndoshë, respektimi i të drejtave të njeriut dhe ekonomia sociale e tregut.

I. Paqe dhe stabilitet

Ideja për Evropën e bashkuar dikur ishte vetëm një ëndërr e filozofëve dhe vizionarëve. Viktor Hygo, për shembull, ka paramenduar "Shtetet e Bashkuara të Evropës" paqësore, të inspiruar nga idealet humaniste. Ëndrra u shkatërrua nga luftërat e tmerrshme të cilat e rrënuan kontinentin gjatë gjysmës së parë të shekullit XX.

Mirëpo, nga gërmadhat e Luftës II Botërore u shfaq një shpresë e re. Njerëzit që kishin rezistuar totalitarizmin gjatë luftës, ishin të vendosur t'i japin fund urrejtjes ndërkombëtare dhe rivalitetit në Evropë, për të ndërtuar një paqe të përhershme. Mes viteve 1945 dhe 1950, një grup burrshtetasish guximtarë, përfshirë këtu Robert Shuman, Konrad Adenauer, Alçide de Gasperi dhe Uinston Çërçill kishin për qëllim t'i bindin popujt e tyre që të hynë në një epokë të re. Struktura të reja do të krijoheshin në Evropën Perëndimore, të bazuara në interesat e përbashkëta dhe të themeluara në bazë të marrëveshjeve të cilat do ta garantonin sundimin e së drejtës dhe barazinë në mes të shteteve.

Robert Shuman (Ministër francez i Punëve të Jashtme), i inspiruar nga një ide fillimisht e krijuar nga Zhan Mone, më 9 maj 1950, propozoi formimin e Komunitetit Evropian

për Thëngjill dhe Çelik (ECSC). Vendet që dikur kishin luftuar njëri-tjetrin, prodhimin e qymyrit dhe të çelikut e bashkuan nën një institucion të përbashkët, të quajtur "Autoriteti i Lartë".

Në mënyrë praktike, por gjithashtu edhe tejet simbolike, materialet e luftës u transformuan në instrument të pajtimit dhe paqes.

II. Bashkimi i sërishëm i Evropës

Bashkimi Evropian e përkrahu bashkimin e Gjermanisë pas rënies së murit të Berlinit në vitin 1989. Kur Bashkimi Sovjetik u shkatërrua në vitin 1991, ish vendet komuniste të Evropës Qendrore dhe Lindore, pas dekadave të lidhjes së ngushtë me Paktin e Varshavës, vendosën që ardhmëria e tyre të jetë në familjen e popujve demokratik të Evropës.

Procesi i zgjerimit vazhdon edhe në ditët e sotme. Në tetor të vitit 2005 kanë filluar bisedimet për anëtarësimin e Turqisë dhe Kroacisë, derisa disa vende të Ballkanit e kanë caktuar rrugën e cila një ditë do t'i shpije në BE.

III. Siguria

Evropa në shekullin XXI akoma ballafaqohet me çështjen e sigurisë. BE-ja duhet të ndërmarrë veprime aktive për ta garantuar

sigurinë e anëtarëve të saj. Në mënyrë konstruktive duhet të bashkëpunojë me rajonet që kufizohen me të: Ballkani, Afrika Veriore, Kaukazi dhe Lindja e Mesme. BE-ja gjithashtu duhet t'i mbrojë interesat e saja ushtarake dhe strategjike nëpërmjet bashkëpunimit me aleatët e saj, në veçanti me aleatët e NATO-s dhe duke zhvilluar një politikë të përbashkët evropiane për siguri dhe mbrojtje.

Siguria e brendshme dhe e jashtme janë dy anët e një monedhe. Lufta kundër terrorizmit dhe krimin të organizuar kërkon nga forcat policore e të gjithë shteteve të BE-së të punojnë së bashku. Të bëhet BE-ja një "rajon i lirisë, sigurisë dhe drejtësisë" ku çdo njëri ka qasje të barabartë në drejtësi dhe mbrojtje të barabartë me ligj, që paraqet një sfidë të re e cila kërkon bashkëpunimin e afërt mes qeverive. Trupat siç janë Europol, Zyra e policisë evropiane dhe Eurojust, të cilat mbështesin bashkëpunimin mes prokurorëve, gjykatësve dhe policëve në vendet e ndryshme të BE-së gjithashtu duhet të luajnë rol më aktiv dhe efektiv.

IV. Solidariteti ekonomik dhe social

Bashkimi Evropian u krijua me qëllim politik për arritjen e paqes, por dinamika dhe suksesi i tij buron nga angazhimi në ekonomi.

Numri i banorëve në shtetet e BE-së është në zvogëlim e sipër në krahasim me popullatën botërore. Prandaj ata duhet të vazhdojnë bashkërisht nëse dëshirojnë të sigurojnë zhvillim ekonomik dhe të jenë të aftë të garojnë në skenën botërore me ekonomitë tjera kryesore. Asnjë shtet i BE-së individualisht nuk është mjaft i fortë për të vepruar vet në tregun botëror. Tregu i vetëm evropian u siguron kompanive një platformë vitale për të garuar në mënyrë efektive në tregjet botërore.

Por konkurrenca e lirë në gjithë Evropën patjetër duhet ta ketë si kundër-baraspeshë solidaritetin gjithë-evropian. Kjo ka përfitime të qarta për qytetarët evropian: kur ato bëhen viktima të vërshimeve dhe katastrofave tjera natyrore, ata marrin ndihmë nga buxheti i BE-së. Fondet Strukturale, të menaxhuara nga

Komisioni Evropian, i përkrahin dhe i plotësojnë përpjekjet e autoriteteve nacionale dhe rajonale të BE-së në zvogëlimin e jo barazive mes pjesëve të ndryshme të Evropës.

Paratë e BE-së dhe kreditë nga Banka Evropiane për Investime (BEI) shfrytëzohen për përmirësimin e infrastrukturës transportuese të Evropës (për shembull, për zgjerimin e rrjetit të autostradave dhe hekurudhës) duke siguruar kështu qasje më të mirë deri te rajonet periferike dhe duke e përkrahur tregtinë trans-evropiane. Suksesi ekonomik i BE-së pjesërisht do të matet edhe nga aftësia që nga tregu i tij i vetëm prej gjysmë miliardë konsumatorësh të përfitojnë sa më shumë njerëz dhe biznese.

V. Identiteti dhe shumë-llojshmëria në botën e globalizuar

Shoqëritë post-industriale të Evropës bëhen çdo herë e më komplekse. Standardi jetësor rritet vazhdimisht, por akoma ekzistojnë dallime të dukshme mes të pasurve dhe të varfërve. Zgjerimi i Evropës i ka zmadhuar edhe dallimet meqenëse shtetet gjatë anëtarësimit kanë pasur standarde jetësore nën mesataren evropiane. Për shtetet e BE-së është me rëndësi të punojnë bashkë me qëllim që ti zvogëlojnë këto dallime.

Por këto përpjekje nuk janë bërë për t'i komprometuar karakteristikat e veçanta kulturore apo gjuhësore të vendeve të BE-së. Përkundrazi, shumë aktivitete të BE-së ndihmojnë në krijimin e rritjes së re ekonomike të bazuar në karakteristikat e rajoneve dhe në shumëllojshmërinë e pasur të traditave dhe kulturave.

Gjysmë shekulli i integritit evropian tregoi se BE-ja si tërësi është më e fuqishme se shuma e pjesëve të saj: ka shumë më tepër fuqi ekonomike, sociale, teknologjike, komerciale dhe politike për dallim nëse anëtarët e saj veprojnë individualisht. Në veprimin e përbashkët dhe të njëzëshëm mund të shihet vlera e shtuar e Bashkimit Evropian.

Pse?

• Sepse BE-ja është fuqia udhëheqëse tregtare



Të bashkuar në shumëllojshmëri – Emri i rrugës në dy gjuhë në Maltë.

botërore dhe prandaj luan rol kyç në negociatat ndërkombëtare siç janë ato në Organizatën Tregtare Botërore (OTB) ku marrin pjesë 149 shtete, si edhe në implementimin e protokollit të Kjetos për ndotjen e ajrit dhe për pengimin e ndryshimeve klimatike.

- Sepse ka pozitë të qartë lidhur me çështjet e ndjeshme që kanë të bëjnë me njerëzit e thjeshtë, siç janë mbrojtja e ambientit jetësor, burimet e ri-përsëritshme energjetike, “parimi i kujdesit” lidhur me sigurinë e ushqimit, aspektet etike të bio-teknologjisë dhe nevoja për mbrojtjen e llojeve të rrezikuara.
- Sepse inicoi iniciativa të rëndësishme për zhvillim të qëndrueshëm në tërë planetin lidhur me “Samitin e Tokës” që u mbajt në vitin 2002 në Johannesburg.

E thëna e vjetër “uniteti është fuqi” sot është më relevante se çdo herë për evropianët. Por, procesi i integritimit evropian nuk i pakësoi mënyrat e ndryshme të jetesës, traditave dhe kulturave të popujve. Në të vërtetë BE-ja e konsideron shumëllojshmërinë si një nga vlerat e saj kyçe.

VI. Vlera

BE-ja dëshiron t’i promovojë vlerat njerëzore dhe progresive dhe të sigurojë se njerëzimi është shfrytëzuesi e jo viktimja e ndryshimeve

të mëdha globale. Nevojat e njerëzve nuk mund thjesht të plotësohen me forcat e tregut apo me ndonjë veprim të njëanshëm.

Prandaj BE-ja qëndron në pikëpamjen e humanizmit dhe për model të shoqërisë të cilën shumica e qytetarëve e përkrahin. Evropianët kujdesen për trashëgiminë e pasur të vlerave, të cilat përfshijnë besim në të drejtat e njeriut, solidaritetin social, ekonominë e lirë, distribucionin e drejtë të frutave të rritjes ekonomike, e drejta për mbrojtjen e mjedisit, respektim të shumëllojshmërisë kulturore, gjuhësore dhe religjioze dhe një përzierje harmonike e traditës dhe progresit.

Konventa Evropiane për të Drejtat Themelore, e cila u miratua në Nicë në vitin 2000, i përmban të gjitha të drejtat që sot njihen nga ana e shteteve anëtare të BE-së dhe qytetarëve të saj. Këto vlera mund të krijojnë ndjenjë të lidhjes familjare me evropianët. Të përmendim vetëm një shembull, të gjitha vendet e BE-së e kanë abroguar dënimin me vdekje.



A low-angle photograph of a person climbing a blue metal ladder against a clear blue sky. The person is silhouetted against the bright background. The ladder is the central focus, extending from the bottom left towards the top right. The overall mood is one of upward movement and achievement.


2. Dhjetë hapat historikë



- 1951: U themelua Bashkësia Evropiane për Thëngjill dhe Çelik nga ana e gjashtë anëtarëve themelues
- 1957: Marrëveshja e Romës e themeloi tregun e përbashkët
- 1973: Bashkësia zgjerohet në nëntë vende anëtare dhe i zhvillon politikat e saj të përbashkëta
- 1979: Organizohen zgjedhjet e para për Parlamentin Evropian
- 1981: Zgjerimi i parë drejt Mesdheut
- 1993: Rrumbullakimi i tregut të vetëm
- 1993: Marrëveshja e Mاستrihitit e themeloi Bashkimin Evropian
- 1995: BE-ja zgjerohet në 15 anëtare
- 2002: Hyjnë në përdorim bankënotat dhe monedhat Euro
- 2004: Unionit i bashkëngjiten edhe 10 shtete

1. Më 9 maj të vitit 1950, Deklarata e Shumanit propozon themelimin e **Bashkësisë Evropiane për Thëngjill dhe Çelik (ECSC)**, që u bë realitet me Marrëveshjen e Parisit, të nënshkruar më 18 prill të vitit 1951. Në këtë mënyrë u krijua tregu i vetëm i thëngjillit dhe çelikut mes gjashtë vendeve themeluese (Belgjika, Republika Federale e Gjermanisë, Franca, Italia

Luksemburgu dhe Holanda). Qëllimi ishte që të sigurohet paqja mes ngadhënjyesve dhe kombeve që u mposhtën pas Luftës së Dytë Botërore dhe të njëjtit të bashkohen në strukturë institucionale, ku do të bashkëpunojnë si partnerë të barabartë.



© EC

Më 9 maj të vitit 1950, ministri francez i Punëve të Jashtme, Robert Shuman, për herë të parë publikisht foli për idetë mbi të cilat qëndron Bashkimi Evropian. Prandaj 9 maji kremtohet si ditëlindja e BE-së.

2. Më vonë, më 25 mars të vitit 1957, gjashtë shtetet vendosën me **Marrëveshjen e Romës**, të krijojnë **Bashkësinë Ekonomike Evropiane (EEC)**, e bazuar mbi tregun e vetëm për asortiment të gjerë të mallrave dhe shërbimeve. Më 1 korrik të vitit 1968, doganat mes gjashtë shteteve u hoqën tërësisht, ndërsa në vitet e '60 u krijuan politika të përbashkëta me theks mbi tregtinë dhe bujqësinë.

3. Ky hap ishte aq i suksesshëm sa që edhe Danimarka, Irlanda dhe Britania e Madhe vendosën t'i bashkëngjiten Bashkësisë. Zgjerimi i parë, nga gjashtë në nëntë anëtare, ndodhi në vitin 1973. Në të njëjtën kohë, u zbatuan **politika e re sociale dhe politika për mbrojtjen e ambientit jetësor**, ndërsa në vitin 1975 u themelua Fondi Evropian për Zhvillim Rajonal (ERDF).

4. Qershori i vitit 1979 ishte dëshmitar i hapit vendimtar për Bashkësinë Evropiane, me

zgjedhjet e para për Parlamentin Evropian, me anë të drejtës universale të drejtpërdrejtë për votë. Këto zgjedhje mbahen çdo pesë vjet.

5. Në vitin 1981 Greqia iu bashkëngjiti Bashkësisë, ndërsa pas saj edhe **Spanja dhe Portugalia** në vitin 1986. Këto zgjerime e forcuan prezencën e Bashkësisë në Evropën Jugore dhe e theksuan nevojën për zgjerim urgjent të programeve të saja për ndihmë të rajoneve më pak të zhvilluara.

6. Kriza ekonomike botërore në vitet e hershme të '80 shkaktoi një valë të "evro-pesimizmit". Por, shpresa rilindi në vitin 1985, kur Komisioni Evropian, nën kryesimin e Zhak Delorit, e publikoi "Librin e bardhë" që përcaktonte formimin e **tregut unik** evropian deri më 1 janar të vitit 1993. Ky qëllim ambicioz u përfshi në Aktin Unik Evropian, që u nënshkrua në shkurt të vitit 1986 dhe hyri në fuqi më 1 korrik të vitit 1987.



© Reuters

Muri i Berlinit ra në vitin 1989, ndërsa ndarja e parë në kontinentin evropian ngadalë filloi të zhduket



7. Trajta politike e Evropës ndryshoi në mënyrë me rënien e **Murit të Berlinit** në vitin 1989. Kjo solli deri në ribashkimin e Gjermanisë në tetor të vitit 1990 dhe demokratizimin e vendeve nga Evropa Qendrore dhe Lindore kur ato u liruan nga kontrolli sovjetik. Bashkimi Sovjetik pushoi së ekzistuari në dhjetor të vitit 1991.

Ndërkohë, vendet-anëtare negocionin rreth Marrëveshjes së re të Bashkimit Evropian, të miratuar nga Këshilli i Evropës, i përbërë nga kryetarët dhe/ose kryeministrat, në Mاستriht, në dhjetor të vitit 1991. Marrëveshja hyri në fuqi më 1 nëntor të vitit 1993. Me krijimin e fushave të reja të bashkëpunimit ndërqeveritar në strukturat e integruara ekzistuese të Bashkësisë, Marrëveshja e krijoi Bashkimin Evropian (BE).

8. Dinamizmi i ri evropian dhe ndryshimi i gjeopolitikës së kontinentit bëri që edhe tre shtete – **Austria, Finlanda dhe Suedia** – t'i bashkohen BE-së, më 1 janar të vitit 1995.

9. Në atë kohë, BE-ja gjendet në rrugën drejt arritjes më spektakulare, krijimin e **valutës së vetme**. Euroja u vu në qarkullim për transaksione financiare (me të holla jo të gatshme) në vitin 1999, derisa bankënotat dhe monedhat u lëshuan në qarkullim tre vjet më vonë në 12 vendet në hapësirën e euros (që njihet si euro zona). Sot euroja është valutë e rëndësishme botërore për pagesë dhe për rezerva dhe ka status të ngjashëm me dollarin amerikan.

Evropianët janë të ballafaquar me globalizimin. Teknologjitë e reja dhe suksesi i internetit janë duke i transformuar ekonominë botërore, por njëkohësisht me vete sjellin sfida sociale dhe kulturore.

Në mars të vitit 2000, BE-ja e miratoi **“Strategjinë e Lisbonës”** me qëllim të modernizimit të ekonomisë evropiane dhe për t'i mundësuar asaj të jetë konkurruese në tregun botëror me lojtarët tjerë kryesorë, siç janë SHBA-të dhe shtetet e reja të industrializuara. Strategjia e Lisbonës nënkupton stimulimin e risive teknologjike, investimet afariste dhe modernizimin e sistemit arsimor të Evropës, për t'i plotësuar nevojat e një shoqërie informatike.

Ndërkohë, papunësia dhe shpenzimet në rritje të pensioneve ndikojnë mbi ekonominë nacionale, dhe kjo i bën reformat më të domosdoshme. Votuesit vazhdimisht kërkojnë nga qeveritë e tyre të gjenden zgjidhje për këto çështje.

10. Pothuajse menjëherë pas zgjerimit të Bashkimit Evropian në 15 vende-anëtare, filluan përgatitjet për **zgjerimin e ri në një shkallë të re, të pa provuar më parë**. Nga mesi i viteve '90, vendet e ish-bllokut sovjetik (Bullgaria, Republika e Çekisë, Hungaria, Polonia, Rumania dhe Sllovakia), tre shtetet baltike që më parë ishin pjesë e Bashkimit Sovjetik (Estonia, Letonia dhe Lituania) një republikë e ish- Jugosllavisë (Sllovenia) dhe dy vendet mesdhetare (Qiproja dhe Malta) trokitën në dyert e BE-së.

BE e mirëpriti këtë mundësi për të ndihmuar stabilizimin e kontinentit evropian dhe për t'iu mundësuar këtyre demokracive të reja që t'i ndjejnë përfitimet nga integrimi evropian. Negociatat për anëtarësimin e ardhshëm filluan në dhjetor të vitit 1997. Zgjerimi i BE-së në 25 shtete ndodhi më 1 maj të vitit 2004, kur 10 nga 12 vendet candidate iu bashkëngjitën Unionit. Bullgaria dhe Rumania pasuan me 1 janar të vitit 2007.

3. Zgjerimi dhe politika fqinjësore





- Bashkimi Evropian është i hapur për çdo shtet që i plotëson kriteret demokratike, politike dhe ekonomike për anëtarësim.
- Pas disa zgjerimeve, numri i vendeve-anëtare të BE-së u rrit nga 6 në 27. Disa shtete të tjera tashmë janë kandidatë për anëtarësim.
- Secila nga marrëveshjet për pranimin e vendit-anëtar të ri duhet njëzëri të miratohet nga ana e të gjitha vendeve-anëtare. Para çdo zgjerimi të ardhshëm, BE-ja do ta vlerësojë kapacitetin për pranimin e anëtarit(ve) të ri (nj), si dhe aftësinë e institucioneve të saja për funksionim të suksesshëm.
- Zgjerimet e kaluara e forcuan demokracinë, e bënë Evropën më të sigurt dhe e rritën potencialin e saj për tregti dhe zhvillim ekonomik.

I. Bashkimi i një kontinenti

a. Bashkimi i 25-ve

Në takimin në Kopenhagë, në dhjetor të vitit 2002, Këshilli Evropian ndërmerr hapin më të rëndësishëm në gjithë historinë e integritimit evropian. Me ftesën për anëtarësim në BE të 10 shteteve tjera më 1 maj të vitit 2004, Bashkimi Evropian jo vetëm që e zmadhonte sipërfaqen e vet dhe numrin e popullatës, por u jepte fund ndarjeve në kontinentin tonë, hendek që ndante botën e lirë nga bota komuniste që nga viti 1945.

Zgjerimi i pestë i BE-së ka dimension politik dhe moral. Kjo u mundësoi shteteve – Qipros, Republikës Çeke, Estonisë, Hungarisë, Letonisë, Lituanisë, Maltës, Polonisë, Sllovakisë dhe Sllovenisë – që janë po aq evropiane sa edhe të tjerët, jo vetëm gjeografikisht, por edhe në kontekst të kulturës, historisë dhe aspiratave të tyre, t'i bashkohen familjes demokratike evropiane. Tani ata janë partnerë në projektin e madh të konceptuar nga themeluesit e BE-së.

b. Zgjerimi i mëtejshëm

Bullgaria dhe Rumania, u bënë kandidatë për anëtarësim qysh në vitin 1995. Procesi i negociatave për këto vende zgjati më tepër se për dhjetë të tjerat, sidoqoftë, ato iu bashkëngjitën BE-së me 1 janar 2007, duke rritur numrin e vendeve anëtare në 27.

c. Kandidate për anëtarësim

Turqia, anëtare e NATO-s, që para do kohe e nënshkroi marrëveshjen për asociim me BE, aplikoi për anëtarësim në vitin 1987. Pozita gjeografike dhe historia politike e Turqisë ishin shkaqet që BE-ja gjatë kohë mëdyshej a duhet t'i përgjigjet pozitivisht aplikacionit të saj. Megjithatë, në tetor të vitit 2005, Këshilli i Evropës i filloi negociatat për anëtarësim me Turqinë. Në kohën e njëjtë, i filluan edhe bisedimet me **Kroacinë**, edhe një vend-kandidat. Deri tani nuk është caktuar data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes për anëtarësim me këto dy vende, që vjen pas përfundimit të negociatave për anëtarësim.

d. Ballkani Perëndimor

Vendet nga Ballkani Perëndimor, shumica prej tyre pjesë e ish-Jugosllavisë, kthehen nga Bashkimi Evropian me qëllim të përshejtit të rindërtimit të tyre ekonomik, t'i përmirësojnë marrëdhëniet e tyre – të prishura nga luftërat etnike dhe religjioze, dhe t'i konsolidojnë institucionet e tyre demokratike. BE i dha status të "vendit-kandidat" ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë (IRJM) në nëntor të vitit 2005. Kandidatë tjerë potencial janë Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia, si dhe Kosova nën Rezolutën 1244/99 të KSKB.

II. Kushtet për anëtarësim

a. Kërkesat juridike

Integrimi evropian gjithnjë ka qenë proces i hapur politik dhe ekonomik për të gjitha vendet evropiane, të cilat janë të gatshme t'i pranojnë marrëveshjet themeluese dhe ta miratojnë gjithë pakon e legjislacionit të BE-së. Në pajtim me nenin 237 nga Marrëveshja e Romës "çdo shtet evropian mund të aplikojë për anëtarësim në Bashkësinë".

Neni F nga Marrëveshja e Mاستrihtit plotëson se vendet-anëtare do të kenë "sisteme qeverisëse [...] të bazuara mbi parimet demokratike".

b. "Kriteret e Kopenhagës"

Në vitin 1993, në pajtim me kërkesat e ish-vendeve komuniste për anëtarësim drejt Unionit, Këshilli i Evropës i hartoi tre kriteret që vendet-kandidate duhet t'i plotësojnë para se të bëhen anëtare. Para anëtarësimit, anëtaaret e reja duhet të kenë:

- Institucione stabile që garantojnë demokraci, ushtrimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe respektimin e mbrojtjen e pakicave.
- Ekonomi funksionale të tregut dhe të mundësi për t'u ballafaquar me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut përbrenda Unionit.
- Aftësi për t'i pranuar obligimet e anëtarësisë në BE, përfshirë edhe mbështetje qëllimeve të Unionit. Ato duhet të kenë administratë të aftë publike që t'i zbatojë dhe administrojë në praktikë ligjet e BE-së.

c. Procesi i anëtarësimit

Negociatat për hyrje zhvillohen mes çdo vendi-kandidat dhe Komisionit Evropian, i cili përfaqëson Bashkimin Evropian. Pas përfundimit të negociatave, vendimin për leje për hyrje të vendit të ri në BE duhet të miratohet njëzëri nga ana e vendeve-anëtare ekzistuese që janë në kuadër të Këshillit. Parlamenti Evropian duhet ta japë pëlqimin e vet përmes votimit pozitiv të shumicës absolute të anëtareve. Pastaj, të gjitha marrëveshjet për anëtarësim duhet të ratifikohen nga ana e vendeve-anëtare dhe vendeve-kandidate, në pajtim me procedurat

kushtetuese të secilës prej tyre.

Gjatë negociatave, vendet-kandidate marrin ndihmë nga BE-ja për t'iu mundësuar më lehtë ta arrijnë nivelin e zhvillimit ekonomik në BE. Zgjerimi me 10 vende në vitin 2004, përfshiu një pako prej 41 miliardë euro, mjete të cilat para së gjithash ishin të dedikuara për financimin e projekteve strukturore, me qëllim që t'iu mundësohet këtyre vendeve të reja kandidate t'i plotësojnë kriteret për anëtarësim.

III. Sa mund të zgjerohet BE?

a. Kufijtë gjeografik

Debatet rreth ratifikimit të Marrëveshjes për Kushtetutën e BE-së, që u zhvillua shumicën e vendeve-anëtare, tregoi se shumë evropianë kanë çështje të paqarta për kufijtë përfundimtar të Bashkimit Evropian dhe bile



„Margaritari i Adriatikut” – Dubrovniku, Kroaci.

edhe për identitetin e saj. Nuk ekzistojnë përgjigje të thjeshta për këto pyetje, veçanërisht për shkak të asaj se çdo shtet i sheh ndryshe interesat e tij politike ose ekonomike. Vendet baltike dhe Polonia angazhohen për anëtarësimin e Ukrainës në

BE. Hyrja e mundshme e Turqisë do ta ngrejë pyetjen rreth statusit të disa vendeve nga Kaukazi si Gjeorgjia dhe Armenia.

Edhe krahas asaj që i plotësojnë kriteret për anëtarësim, Islanda, Norvegjia, Zvicra dhe Lihtenshtajni nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian pasi që opinioni publik në këto vende për momentin është kundër inkuadrimit të tyre në Union.

Si problematike mbeten situata politike në Bjellorusi dhe pozita strategjike e Moldavisë. Më se e qartë është se anëtarësimi i Ruisë do të krijonte disbalancë të papranueshme në Bashkimin Evropian, si nga aspekti politik ashtu edhe nga ai gjeografik.

b. Kufizimet administrative

Gjithashtu, rregullat e tanishme për anëtarësim, të definuar me Marrëveshjen nga Nica në vitin 2003, vendosën kornizën institucionale për Unionin me maksimum 27 anëtare. Që të mund të rritet numri i anëtareve do të duhet të përgatitet marrëveshje e re ndër-qeveritare për marrëdhëniet mes vendeve-anëtare në kuadër të institucioneve.

Funksionimi i Unionit në pajtim me parimet themelore të Marrëveshjeve (shihe Kapitullin 4: "Si funksionon BE-ja?") do të jetë e vështirë me më shumë se 30 shtete.

Procedurat për vendosje duhet të shqyrtohen hollësisht me qëllim që të shmanget paraliza dhe t'i mundësohet BE-së të jetë e aftë për veprim.

Gjithashtu, ekzistojnë çështje të ndjeshme si përdorimi i gjuhëve zyrtare. Anëtarësimi i Bullgarisë dhe Rumanisë do ta shtojë numrin e gjuhëve zyrtare në 23. Zgjerimi i BE-së nuk guxon të shkaktojë ndjenjë të njerëzisë e rëndomtë se identiteti i tyre nacional ose rajonal ndryshon në kuadër të një BE të standardizuar.

IV. Vendet-kandidate dhe vendet që nuk janë candidate

Bashkimi Evropian ka dy politika paralele për marrëdhëniet e saja me vendet fqinje,

varësisht nga ajo nëse gjenden ose jo në listën momentale të kandidatëve potencial.

- Marrëveshjet për stabilizim dhe asociim e hapin mundësinë që një vend të bëhet kandidat për anëtarësim në BE pas përfundimit të negociatave për Marrëveshjen. Kroacia dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM) janë vendet e para që nënshkruan marrëveshje të tilla. Pas tyre e nënshkroi Shqipëria, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia.

- Në kuadër të **politikës së saj fqinjësore**, BE-ja ka nënshkruar marrëveshje përkëmbim tregtar dhe bashkëpunim me vendet që nuk janë anëtare të BE-së, e gjenden në Mesdheun Jugor dhe në Kaukazin Jugor, si dhe me vendet në Evropën Lindore, ku marrëdhëniet e tyre të ardhshme me Bashkimin Evropian janë akoma të paqarta.



4. Si funkcionon BE-ja?





- Këshilli i Ministrave i Bashkimit Evropian, që i paraqet vendet anëtare, është organi kryesor i BE-së për sjelljen e vendimeve. Kur takohen në nivel të kryetarëve të shteteve ose qeverive, ai bëhet Këshilli i Evropës, roli i të cilit është t'ia japë BE-së impulsin politik për çështje kyçe.
- Parlamenti i Evropës, që i përfaqëson njerëzit, i ndan kompetencat e legjisllacionit dhe buxhetit me Këshillin e Bashkimit Evropian.
- Komisioni Evropian, që i përfaqëson interesat e përbashkëta të BE-së, është organi kryesor ekzekutiv. Ai propozon ligje dhe kujdeset për atë nëse politikat e BE-së zbatohen në mënyrë adekuatë.

I. Trekëndëshi që merr vendime

Bashkimi Evropian është më shumë se një konfederatë shtetesh, por nuk është shtet federal. Ai, në të vërtetë, është një lloj strukture që nuk merr pjesë në asnjë kategori tjetër tradicionale juridike. Nga perspektiva historike, sistemi i tij politik është unik, dhe i njëjti vazhdimisht po zhvillohet më shumë se 50 vjet.

Marrëveshjet (të njohura si legjisllacion "primar") janë baza e legjisllacionit "sekondar", që ndikon drejtpërdrejtë mbi jetën e

e përditshme të qytetarëve të Bashkimit Evropian. Legjisllacioni sekondar kryesisht përbëhet nga rregulloret, direktivat dhe rekomandimet të miratuara nga ana e institucioneve të BE-së.

Këto ligje, bashkë me politikat e BE-së në përgjithësi, janë rezultat i vendimeve që i merr trekëndëshi institucional i përbërë nga Këshilli (që i përfaqëson qeveritë nacionale), Parlamenti Evropian (që i përfaqëson njerëzit) dhe Komisioni Evropian (organ i pavarur nga qeveritë e BE-së që i mbështet interesat kolektive evropiane).

a. Këshilli i Bashkimit Evropian dhe Këshilli i Evropës

Këshilli i Bashkimit Evropian (i njohur si Këshilli Evropian) është organi kryesor vendimmarrës i BE-së. Kryesimin me Këshillin në mënyrë alternuese e marrin vendet-anëtare të BE-së, çdo gjashtë muaj. Në çdo mbledhje të Këshillit merr pjesë nga një ministër nga çdo vend-anëtar. Se cili ministër do të marrë pjesë varet nga temat që trajtohen: politikë e jashtme, bujqësi, industri, komunikacion, ambienti jetësor, etj.

Këshilli dhe Parlamenti Evropian ndajnë fuqinë legjisllative, në kuadër të procedurës për "bashkë-vendimmarrje". Këshilli dhe Parlamenti e ndajnë edhe përgjegjësinë për miratimin e buxhetit të BE-së. Këshilli lidh marrëveshje ndërkombëtare për të cilat paraprakisht negocion Komisioni.



© EC

Parlamenti Evropian: votimi i tyre është vota juaj.

Numri i votave të çdo shteti në Këshill

Gjermania, Franca, Italia dhe Britania e Madhe	29
Spanja dhe Polonia	27
Rumania	14
Holanda	13
Belgjika, Republika e Çekisë, Greqia, Hungaria dhe Portugalia	12
Austria Bullgaria dhe Suedia	10
Danimarka, Irlanda, Letonia, Sllovakia dhe Finlanda	7
Estonia, Qiproja, Lituania, Luksemburgu dhe Sllovenia	4
Malta	3

Gjithsej: 345

Për çdo shumicë të kualifikuar janë të nevojshme më së paku 255 vota nga gjithsej 345 (73,9%).

Gjithashtu:

- vendimin duhet ta miratojë shumica e vendeve-anëtare (në disa raste dy të tretat)
- secili vend-anëtar mund të kërkojë konfirmim se votat “për” paraqesin 62% nga popullata e përgjithshme e BE-së.

Në pajtim me Marrëveshjet, Këshilli merr vendime me shumicë të thjeshtë, me “shumicë të kualifikuar” votash ose unanimisht, varësisht nga tema për të cilën vendoset.

Këshilli duhet të miratojë vendim unanim për çështje të rëndësishme, siç janë ndryshimet në Marrëveshje, zbatimi i politikave të reja ose dhënia e pëlqimit të Unionit për anëtarësim të ndonjë shteti të ri.

Në të shumtën e rasteve tjera, është e nevojshme shumica e kualifikuar votash. Me fjalë të tjera, Këshilli nuk mund të merr vendim përveç nëse një numër minimal i caktuar votash është në favor të një propozimi. Numri i votave që çdo shtet i BE-së mund t’i japë e reflekton numrin e banorëve në atë shtet.

Këshilli i Evropës takohet katër herë në vit. Me atë kryeson kryetari ose kryeministri i shtetit, që aktualisht kryeson me Këshillin e Bashkimit Evropian. Kryetari i Komisionit Evropian merr

pjesë në takimet si anëtar i barabartë.

Me Marrëveshjen nga Mاستrihti, Këshilli i Evropës zyrtarisht u bë iniciator i politikave të rëndësishme të Unionit dhe iu dhanë kompetencat për çështje të vështira, për të cilat ministrat, në mbledhjet e Këshillit të Bashkimit Evropian dështojnë të pajtohen.

Këshilli i Evropës i përcjell edhe problemet më të rëndësishme botërore nëpërmjet politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë (PBJS), me qëllim që t’i mundësojë BE-së njëzëri të flas për çështje ndërkombëtare.

b. Parlamenti Evropian

Parlamenti Evropian është organ i zgjedhur që i përfaqëson qytetarët e BE-së. Ai kryen kontroll politik mbi aktivitetet e BE-së dhe merr pjesë në procesin legjislativ. Që nga viti 1979, deputetët e Parlamentit Evropian zgjidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me votim të përgjithshëm, çdo pesë vjet.



Numri i deputetëve në Parlamentin Evropian nga çdo vend 2007-09

Austria	18
Belgjika	24
Bullgaria	18
Qiproja	6
Republika e Çekisë	24
Danimarka	14
Estonia	6
Finlanda	14
Franca	78
Gjermania	99
Greqia	24
Hungaria	24
Irlanda	13
Italia	78
Letonia	9
Lituania	13
Luksemburgu	6
Malta	5
Holanda	27
Polonia	54
Portugalia	24
Rumania	35
Slovakia	14
Slovenia	7
Spanja	54
Suedia	19
Britania e Madhe	78
Gjithsej	785


Zakonisht, Parlamenti i Evropës mbledhjet plenare i mban në Strasburg, ndërsa mbledhjet tjera në Bruksel. Parlamenti ka dhjetë komisione të cilat i përgatisin mbledhjet plenare, si dhe disa grupe politike që zakonisht takohen në Bruksel. Sekretariati gjeneral i Parlamentit gjendet në Luksemburg dhe Bruksel. Parlamenti merr pjesë në punën legjislative të BE-së në tre nivele:

* Me "procedurën e bashkëpunimit", që u miratua me Aktin Unik Evropian në vitin 1987, Parlamenti jep mendimet e veta për propozim direktivat dhe propozim-rregulloret që i propozon Komisioni Evropian, i cili mund t'i ndryshojë për të marrë parasysh mendimet e Parlamentit.

• Nga viti 1987 ekziston edhe "procedura e pëlqimit", me të cilën Parlamenti i Evropës patjetër duhet të pajtohet për marrëveshjet ndërkombëtare të negociuara nga Komisioni, si dhe për çdo propozim për zgjerim të Bashkimit Evropian.

• Marrëveshja nga Mاستrihti nga viti 1992 e miratoi "procedurën e bashkëndimit", me të cilën Parlamentin e ka vendosur në pozitë të njëjtë me Këshillin, kur vendoset për korniza ligjore për një sërë çështjesh të rëndësishme, siç janë lëvizja e lirë e punëtorëve, tregu i brendshëm, arsimi,

Grupet politike në Parlamentin e Evropës



hulumtimet, ambienti jetësor, rrjeti trans-evropian, shëndetësia, kultura, mbrojtja e konsumatorëve etj. Parlamenti ka fuqinë që të refuzojë legjislacionin e propozuar në këto sfera, nëse shumica absolute e parlamentarëve votojnë kundër “qëndrimit të përbashkët” të Këshillit. Mirëpo, marrëveshja ka rregullore me të cilën parashihet procedura për pajtim.

Parlamenti Evropian dhe Këshilli po ashtu ndajnë përgjegjësi të njëjtë për miratimin e buxhetit të BE-së. Parlamenti mund të refuzojë buxhetin e propozuar dhe këtë tani e ka bërë disa herë. Në atë rast, e gjithë procedura për miratimin e buxhetit duhet të rifillojë. Komisioni Evropian propozon buxhetin, që më pastaj debatohet nga Këshilli dhe Parlamenti. Parlamenti ka shfrytëzuar plotësisht kompetencat buxhetore për të ndikuar në procesin politik të BE-së.

Më në fund, por jo më pak e rëndësishme, Parlamenti i Evropës është organ që zbaton kontroll demokratik mbi Unionin. Ka fuqinë të suspendojë Komisionin. Për këtë është e nevojshme shumica e dy të tretave. Parlamenti, gjithashtu, e mbikëqyrë zbatimin e politikave të BE-së nëpërmjet pyetjeve me shkrim dhe verbale drejtuar Komisionit dhe Këshillit. Kryetari i tanishëm i Këshillit Evropian i raporton Parlamentit për vendimet që i merr Këshilli.

c. Komisioni Evropian

Komisioni është pjesa e tretë e trekëndëshit institucional që menaxhon dhe udhëheq me Bashkimin Evropian. Anëtarët e tij emërohen çdo pesë vjet me anë të marrëveshjes mes vendeve-anëtare, e të njëjtit i miraton Parlamenti i Evropës. Komisioni raporton para Parlamentit dhe nëse Parlamenti voton mosbesim, Komisioni duhet të japë dorëheqje kolektive.

Nga viti 2004, Komisioni do të ketë nga një komisionar nga çdo vend-anëtar.

Komisioni ka shkallë të lartë pavarësie në punën e vet. Detyra e tij është t'i përfaqësojë interesat e përbashkëta, ashtu që nuk duhet të pranojë instruksione nga asnjë qeveri të ndonjë shteti anëtar.

Si “mbrojtës i marrëveshjeve”, Komisioni duhet të sigurojë se rregulloret dhe direktivat e miratuara nga Këshilli dhe Parlamenti, zbatohen në praktikë. Në të kundërtën, Komisioni palën që nuk i zbaton ligjet e BE-së mund ta nxjerrë para Gjykatës së Drejtësisë, që ta detyrojë ta bëjë atë.

Si ekzekutiv i BE-së, Komisioni i zbaton vendimet e Këshillit në fusha siç janë politikat e përbashkët bujqësore.

Në pjesën më të madhe, Komisioni është kryesisht përgjegjës për zbatimin e politikave të përbashkëta të BE-së në fusha si hulumtimet dhe teknologjia, ndihmat për zhvillim, zhvillimi rajonal etj.

Komisioni krahas kësaj menaxhon edhe me buxhetin për këto veprime.

Administrata e komisionit është e përbërë nga 36 drejtori gjenerale (DGJ) dhe shërbime, të vendosura në Bruksel dhe Luksemburg.

I. Institucione dhe organe tjera

a. Gjykata e Drejtësisë

Gjykata e Drejtësisë e Bashkësive Evropiane, me seli në Luksemburg, përbëhet nga një gjykatës prej çdo shteti të BE-së dhe tetë avokatë publik. Ata emërohen me marrëveshje të përbashkët të qeverive të shteteve anëtare. Çdonjëri emërohet për mandat gjashtëvjeçar. Pavarësia e tyre është e garantuar. Detyra e Gjykatës është të sigurohet respektimi i të drejtës së BE-së dhe të sigurojë interpretim dhe aplikim të marrëveshjeve.

b. Gjykata e Revizorëve

Gjykata e Revizorëve është formuar në vitin 1977. Gjykata ka nga një anëtar prej çdo shteti të BE-së, që emërohet me mandat gjashtëmujor me marrëveshje mes shteteve anëtare, pasi që konsultohet Parlamenti i Evropës. Gjykata e Revizorëve kontrollon se të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e Bashkimit Evropian janë kryer në mënyrë ligjore dhe të rregullt, dhe se buxheti i BE-së është menaxhuar në mënyrë korrekte.



Gjykata e Drejtësisë kontrollon nëse respektohen ligjet e BE-së; për shembull kujdeset nëse nënat trajtohen në mënyrë adekuate pasi të kthehen në punë.

c. Komiteti Evropian për Çështje Ekonomike dhe Sociale

Kur vendosin për çështje nga sfera të ndryshme politike, Këshilli dhe Komisioni këshillohen me Komitetin Evropian për Çështje Ekonomike dhe Sociale (EESC). Anëtarët e tij përfaqësojnë grupe të ndryshme të interesit, që kolektivisht përbëjnë "shoqërinë e organizuar civile". Anëtarët me mandat katërvjeçar emërohen nga Këshilli.

d. Komiteti i Rajoneve

Komiteti i Rajoneve (KR), i formuar me Marrëveshjen për Bashkimin Evropian, përbëhet nga përfaqësuesit e qeverive rajonale dhe lokale, të propozuar nga shtetet anëtare dhe të emëruar nga Këshilli, me mandat katërvjeçar. Marrëveshja parasheh që Këshilli dhe Komisioni ta konsultojnë KR për çështje të rëndësishme për rajonet. Komiteti gjithashtu mund të jep mendime me vetiniciativë.

e. Banka Evropiane e Investimeve

Banka Evropiane e Investimeve (EIB), me seli në Luksemburg, jep huazime dhe garanci për

t'u ndihmuar rajoneve më pak të zhvilluara të BE-së dhe bizneseve të vogla, që ato t'i bëjë më konkurruese.

f. Banka Qendrore Evropiane

Banka Qendrore Evropiane (ECB), me seli në Frankfurt, është përgjegjëse për të menaxhuar me euron dhe politikën monetare të BE-së (shih kapitullin 7 "Unioni ekonomik dhe monetar (BEM) dhe euroja").



5. ka b n BE-ja?





- Bashkimi Evropian vepron në fushën ekonomike, sociale, rregullative dhe financiare. Në kuadër të këtyre veprimeve, aktivitetet e Unionit janë të dobishme për shtetet-anëtare. Ato përfshijnë:
 - politikat e solidaritetit (të njohura edhe si politika të kohezionit) lidhur me çështjet rajonale, bujqësore dhe sociale;
 - politikat e risive teknologjike, ku teknologjitë më të larta i aplikojnë në fusha siç janë mbrojtja e ambientit jetësor, hulumtimi dhe zhvillimi (H & ZH), dhe energjia.
- Unioni i financon këto politika përmes buxhetit vjetor me shumë prej 120 miliardë euro, që kryesisht mbulohej nga shtetet anëtare. Kjo paraqet pjesë të vogël të pasurisë kolektive të BE-së (maksimum 1.24% nga bruto të ardhurat kombëtare të kombinuar të të gjitha shteteve anëtare)

I. Politikat e solidaritetit

Qëllimi kryesor i politikave për solidaritet është ta mbështesin krijimin e tregut unik (shih kapitullin 6 "Tregu unik") dhe ta tejkalojnë pabarazinë me anë të përdorimit të masave strukturore të dedikuara për ndihmë rajoneve që mbesin prapa ose sektorëve industrial që ballafaqohen me vështirësi.

Nevoja për solidaritet mes vendeve të BE-së, si dhe mes rajoneve të caktuara, u bë edhe më e nevojshme me hyrjen e 12 shteteve të reja me të ardhura më të vogla se mesatarja e BE-së. BE-ja gjithashtu duhet të ketë rol në ristrukturimin e atyre sektorëve në ekonomi që janë të goditur nga ana e konkurrencës ndërkombëtare që është në rritje e sipër.

a. Ndihma rajonale

Politika rajonale e BE-së nënkupton përcjelljen e fondeve nga buxheti i BE-së në rajonet që kanë nevojë për këtë. Fondet shfrytëzohen për të nxitur zhvillimin në rajonet e prapambetura, për t'i ringjallur zonat e vjetra industriale, për punësimin e të rinjve dhe të papunësuarit, për modernizimin e bujqësisë dhe për t'i ndihmuar rajoneve rurale të lëna pas dore.

Fondet e dedikuara për aktivitete rajonale në kuadër të buxhetit për periudhën 2007-13 kanë tre qëllime.

- **Afrimi i ndërsjellë.** Qëllimi është t'u ndihmohet vendeve dhe rajoneve të pazhvilluara t'i vënë në lëvizje ekonominë dhe t'i afrohen mesatares së BE-së, nëpërmjet përmirësimit të kushteve për rritje ekonomike dhe punësim. Kjo bëhet përmes investimit në kapitalin njerëzor dhe fizik, risitë teknologjike, shoqëri e bazuar në arsim, harmonizimin ndaj ndryshimeve, ambientit jetësor dhe administratë të suksesshme.

- **Konkurrenca rajonale dhe punësimi.**

Qëllimi është të rritet konkurrenca, niveli i punësimit dhe tërheqja e rajoneve që nuk gjenden në grupin e atyre më pak të zhvilluara. Kjo bëhet përmes parashikimit të ndryshimeve ekonomike dhe sociale dhe inkurajimin e risive teknologjike, sipërmarrjes, mbrojtjen e ambientit jetësor, qasjes, aftësimin dhe zhvillimin e tregjeve të hapura të punës.

- **Bashkëpunimi territorial evropian.** Ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit ndërkufitar, Trans-nacional dhe ndër-rajonal. Gjithashtu i mbështet zgjidhjet e përbashkëta ndaj problemeve, me të cilat ballafaqohen autoritetet në vendet fqinje në sektorin urban, rural dhe zhvillimin bregdetar, zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike dhe lidhjen mes ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM).

BE do të përdorë mjete të veçanta për plotësimin e këtyre qëllimeve, me të cilat do të plotësohen ose do të stimulohen investimet nga ana e sektorit privat dhe nga ana e qeverive nacionale dhe rajonale.

Këto mjete janë të njohura si Fonde strukturore dhe Fonde kohezive.

• **Fondi evropian për zhvillim rajonal (ERDF)** është fondi i parë strukturor që siguron mjete për forcimin e kohezionit ekonomik, social dhe territorial nëpërmjet zvogëlimit të dallimeve mes rajoneve dhe nëpërmjet mbështetjes zhvillimit strukturor dhe harmonizimit të ekonomive rajonale, duke përfshirë edhe përtëritjen e rajoneve industriale të lëna pas dore.


• **Fondi social evropian (ESF)**, fondi i dytë strukturor, siguron mjete për arsimim profesional dhe për iniciativa për hapjen e vendeve të punës.

• Si plotësim i Fondeve strukturore, ekziston edhe **Fondi koheziv**, që ka për qëllim financimin e infrastrukturës së komunikacionit dhe të projekteve nga fusha e ambientit jetësor në vendet e BE-së, ku GDP për banor është më pak se 90% nga mesatarja e BE-së.

b. Politika e përbashkët bujqësore (PPB)

Qëllimet e PPB, të cekura në Marrëveshjen e Romës nga viti 1957, pothuaj janë arritur: bujqve iu është mundësuar standardi i mirë jetësor; tregjet janë stabilizuar; konsumuesit kanë qasje deri te prodhimet e lira; strukturat bujqësore janë modernizuar. Edhe parimet tjera që janë miratuar me kohë u treguan si të dobishme. Konsumuesit janë të sigurt në cilësinë e prodhimeve, ndërsa çmimet e prodhimeve bujqësore mbetën stabile, të mbrojtura nga fluktuimet e tregut botëror. Buxheti për PPB quhet **Fondi Evropian për udhëheqje bujqësore dhe garanci**.

Por, PB u bë viktimë e suksesit të vet. Prodhimtaria rritej shumë më shpejtë se konsumimi, që paraqiste barë të madhe për buxhetin e BE-së. Politika bujqësore duhej të



© Chris Windsor/Photodisc Red/Getty Images

Prodhimi i ushqimit që e hamë: cilësia është njëlloj e rëndësishme si sasia.

reformohej me qëllim që të tejkalohet ky problem. Kjo reformë filloi të jap rezultate. Prodhimtaria u ngadalësua. Bujqit u inkurajuan që të përdorin metoda të qëndrueshme bujqësore, me të cilën mbrohet ambienti jetësor, ta ruajnë ambientin njerëzor, dhe të kontribuojnë për përmirësimin e cilësisë dhe sigurisë së ushqimit.

Roli i ri i komunitetit bujqësor është që të sigurojë një numër të caktuar aktivitetesh ekonomike në çdo rajon rural dhe të ruajë diversitetin e fushave pjellore të Evropës. Ky diversitet dhe "mënyra rurale e jetesës" -njerëzit duke jetuar në harmoni me tokën - janë pjesë e rëndësishme e identitetit të Evropës.

Bashkimi Evropian nga Organizata Tregtare Botërore (OTB) ka kërkuar që theksi më i madh t'i vihet cilësisë së ushqimit, parimin e masave parandaluese dhe mirëqenien e kafshëve. Gjithashtu Bashkimi Evropian filloi me reformat edhe në politikat për peshkim. Qëllimi është që të zvogëlohet kapaciteti tepër i madh i peshkimit të shpejtë, të ruhet fondi i peshqve dhe financiarisht t'u ndihmohet peshkatarëve që të zhvillojnë aktivitete tjera ekonomike.



c. Dimensioni social

Qëllimi i politikës sociale të BE-së është të përmirësojë pabarazitë më të dukshme në shoqërinë evropiane. Fondi Social Evropian (ESF) u formua në vitin 1961 për të promovuar krijimin e vendeve të reja të punës dhe për t'i ndihmuar punëtorëve që të lëvizin nga një vend pune në një tjetër ose nga një zonë gjeografike në një zonë tjetër.

Ndihma financiare nuk është mënyra e vetme përmes së cilës BE-ja përpiket t'i përmirësojë kushtet sociale në BE. Ajo nuk është e mjaftueshme për t'i zgjidhur problemet e shkaktuara nga kriza ekonomike ose nga prapambetja rajonale në zhvillim. Progresi social buron pikësepari nga rritja ekonomike. Kjo shkon paralelisht me legjislacionin i cili garanton pakon e të drejtave minimale. Disa nga këto të drejta janë të përfshira në Marrëveshjet, për shembull të drejtat e meshkujve dhe femrave për pagë të njëjtë kur të dy kryejnë punë të njëjtë. Të drejtat tjera janë të përcaktuara në direktivat për mbrojtjen e punëtorëve (mbrojtja shëndetësore dhe mbrojtja gjatë punës) dhe për standardet esenciale të sigurisë.

Në vitin 1991, në Mاستriht, Këshilli i Evropës e miratoi **Kartën e Bashkësisë për të drejtat themelore sociale**, duke përcaktuar kështu të drejtat që duhet t'i gëzojnë të gjithë punëtorët në BE: lëvizje e lirë; pagesë korrekte; kushte më të mira për punë; mbrojtje sociale; të drejtën për të formuar shoqata dhe të drejtën për të përfaqësuar në biseda kolektive; të drejtën për trajnime profesionale; trajtim të njëjtë për femrat dhe meshkujt; informim, këshillim dhe participim të punëtorëve; mbrojtje shëndetësore dhe mbrojtja gjatë punës; mbrojtje për fëmijët, më të vjetrit dhe handikapët.

Në Amsterdam, në qershor të vitit 1997, kjo Kartë u bë pjesë integrale e Marrëveshjes dhe aplikohet në të gjitha shtetet anëtare.

II. Politikat lidhur me inovacionet

Aktivitetet e Bashkimit Evropian kanë ndikim në përditshmërinë e qytetarëve të vet, ku i përfshin sfidat e vërteta me të cilat ballafaqohet shoqëria: mbrojtja e ambientit

jetësor, shëndeti, risitë teknologjike, energjia etj.

a. Mjedisi jetësor dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Thelbi i aktiviteteve të BE-së në fushën e ambientit jetësor është programi i quajtur "Mjedisi jetësor 2010: ardhmëria jonë, zgjedhja jonë". Ky program e përfshin periudhën prej vitit 2001 deri më 2010 dhe i përfshin këto nevoja:

- të zbuten dhe të ngadalësohen ndryshimet klimatike dhe ngrohja globale;
- të mbrohen resurset natyrore dhe flora e fauna;
- të gjenden zgjidhje për problemet lidhur me ambientin jetësor dhe shëndetin;
- të ruhen resurset natyrore dhe menaxhimi e sukses i mbeturinave.

Zbatimit të këtij programi i paraprinin pesë programe, si dhe zhvillimi i standardeve në periudhën prej më shumë se 30 vjet, ku BE-ja ia arriti të vendos sistem gjithëpërfshirës për mbrojtjen e ambientit jetësor.

Problemet me të cilat ballafaqohet BE-ja janë të llojllojshme: zhurma, mbeturinat, mbrojtja e resurseve natyrore, gazrat dalëse, substancat kimike, fatkeqësitë industriale, pastërtia e ujit për pastrim, si dhe formimi i rrjetit evropian për informata dhe ndihmë gjatë rasteve urgjente, që do të shërbente gjatë fatkeqësive që e rrezikojnë ambientin jetësor, siç janë derdhja e naftës ose zjarret në rajonet pyjore.

Para do kohe u hartua plani për ambientin jetësor dhe shëndet për periudhën 2004- 10, ku u shqyrtuan çështjet lidhur me ndikimin e ndotjes mbi shëndetin e njeriut. Plani e dëfinon lidhshmërinë mes shëndetit, ambientin jetësor dhe politikën e hulumtimit.

Legjislacioni evropian siguron nivel të njëjtë të mbrojtjes për gjithë BE-në, por njëkohësisht ai është fleksibil dhe i merr parasysh kushtet lokale. Legjislacioni vazhdimisht azhurnohet. Për shembull, u miratua vendimi që të

përpunohet rregullorja ligjore për substancat kimike dhe të ndryshohen rregulloret paraprake, të cilat janë definuar një nga një, me një sistem të vetëm për regjistrim, vlerësim dhe autorizim të substancave kimike (RVASK).



© Andersen Ross/Digital Vision/Getty Images

Hulumtimi ushqen zhvillimin ekonomik

Ky sistem bazohet në qendrën e informatave që menaxhohet nga ana e Agjencisë Evropiane për Substanca Kimike, me seli në Helsinki. Qëllimi i saj është të shmanget ndotja e ajrit, ujit, tokës ose ndërtesave, të ruhet bio-diversiteti dhe të përmirësohet shëndeti dhe siguria e qytetarëve të BE-së, e njëkohësisht të ruhet konkurrenca e industrisë evropiane.

b. Risitë teknologjike

Themeluesit e Bashkimit Evropian me të drejtë panë se prosperiteti i Evropës në të ardhmen do të varet nga aftësia e saj të mbetet lider botëror në teknologji. Ata i panë përparësitë që mund t'i kenë hulumtimet e përbashkëta evropiane. Kështu, në vitin 1958, bashkë me BEE, ata formuan Euroatom – Bashkësinë Evropiane për Energji Atomike. Qëllimi i tij ishte që t'u mundësojë shteteve anëtare që bashkërisht të eksploatojnë energjinë atomike për qëllime paqësore. Në atë kontekst, ata formuan edhe Qendër të Përbashkët Hulumtuese (JRC), të përbërë nga nëntë institute hulumtimi, të vendosura në katër

anë: Ispa (Itali), Karlsruhë (Gjermani), Peten (Holandë) dhe Gel (Belgjikë).

Por, kur rinovimet shkencore dhe teknologjike fituan në intensitet, ekipi hulumtues evropian u bë i larmishëm, duke sjellë në një vend numër të madh të shkencëtarëve dhe hulumtuesve të ndryshëm. BE duhej të gjejë mënyra të reja për të financuar punën e tyre dhe aplikimet e reja për zbulimet e tyre.

Qëllimi i hulumtimit të përbashkët në nivel të BE-së është dizajnuar të plotësojë programet hulumtuese nacionale. Përqendrohet në projekte që përfshijnë një numër laboratorësh në shtete të ndryshme të BE-së. Mbështet hulumtimet fundamentale në sfera, siç janë fuzioni i kontrolluar termonuklear (burim potencial dhe i pafund i energjisë në shekullin 21). Gjithashtu BE-ja e inkurajon hulumtimin dhe zhvillimin teknologjik në veprimtaritë kyçe, siç janë elektroteknika dhe kompjuterët, që hasin në konkurrencë të fuqishme jashtë Evropës.

Bartësi kryesor për financimin e hulumtimeve në nivel të BE-së janë disa korniza programore. **Korniza e shtatë programore për hulumtime dhe zhvillim teknologjik** e përfshinë periudhën prej 2007-13. Pjesa më e madhe e buxhetit, me shumë prej 50 miliardë euro, do të dedikohet për fusha siç janë shëndetësia, ushqimi dhe bujqësia, teknologjia informatike dhe komunikuese, nano-teknologjitë, energjia, ambienti jetësor, komunikacioni, siguria, dhe hulumtimet e gjithësisë dhe shkencën socio-ekonomike. Programet tjera do të përfshijnë promovimin e ideve, njerëzve dhe kapaciteteve, nëpërmjet punës hulumtuese të diturisë, mbështetjes së hulumtuesve dhe zhvillimin e karrierës së tyre, si dhe për bashkëpunim ndërkombëtar.

c. Energjia

Lëndët djegëse fosile – nafta, gazi natyror dhe thëngjilli – përfshijnë 80% nga energjia e shpenzuar në Evropë. Pjesën më të madhe të këtyre lëndëve djegëse fosile BE-jai importon nga jashtë. Për momentin, 50% nga gazi dhe nafta që i shfrytëzon BE-ja i importon, ndërsa varshmëria e tillë mund të rritet në 70% deri në vitin 2030. Për këtë shkak, BE-ja do të ketë restriksione ose rritje të çmimeve të shkaktuara nga krizat ndërkombëtare. Edhe



Shfrytëzimi i burimeve natyrore të energjisë në planet është vetëm një mënyrë e luftës kundër ndryshimeve klimatike.

një shkak për zvogëlimin e konsumimit të lëndëve djegëse fosile është të ndryshojë procesi i ngrohjes globale.

Në të ardhmen do të duhet të bëhen më shumë hapa, siç janë kursimi i energjisë me anë të përdorimit të saj sipas nevojës, zhvillimin e burimeve energjetike alternative (veçanërisht, burime energjetike të përsëritshme në Evropë), dhe rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Shpenzimi i energjisë do të mund të zvogëlohej për një të pestën deri në vitin 2020, nëse konsumuesit e ndryshojnë sjelljen e tyre dhe nëse i përdorin tërësisht teknologjitë që e përmirësojnë efikasitetin e energjisë.

III. Pagesa për Evropën: buxheti i BE-së

BE-ja disponon me buxhet vjetor prej mbi 120 miliardë euro për financimin e politikave të saja. Ky buxhet është i financuar nga ajo që quhet "mjete vetanake" të BE-së, të cilat nuk guxojnë ta tejkalojnë shumën prej 1.24% nga bruto të ardhurat nacionale të gjitha vendeve-anëtare.

Këto mjete kryesisht grumbullohen nga:

- taksat doganore për mallrat e importuara në BE, duke përfshirë edhe tatimet bujqësore;
- përqindja e tatimit të vlerës së shtuar që llogaritet për mallrat dhe shërbimet në kuadër të BE-së;
- kontributet e vendeve-anëtare në pajtim me pasurinë e tyre.

Secili buxhet vjetor nga periudha shtatëvjeçare buxhetore është i njohur si "perspektivë financiare". Komisioni Evropian e përpilon propozim perspektivën financiare, që pastaj duhet njëzëri të miratohet nga ana e vendeve-anëtare, e për ato duhet të negociohet me Parlamentin Evropian dhe të miratohet nga ai. Buxheti i përgjithshëm për perspektivën financiare 2007-13 është 864,4 miliardë euro.



6. Tregu unik





- Tregu unik është një ndër arritjet më të mëdha të Bashkimit Evropian. Përkufizimet mes vendeve anëtare lidhur me tregtinë dhe konkurrencën e lirë gradualisht janë mënjtuar, që rezultoi me standard më të mirë të jetesës.
- Tregu unik akoma nuk është bërë zona unike ekonomike. Disa sektorë ekonomikë (shërbimet publike) ende janë nën kompetencat e ligjeve nacionale.
- Secili nga vendet e BE-së ende i ka kompetencat për tatimin dhe politikën sociale.
- Tregu unik e ka mbështetjen në disa politikave tjera të ngjashme të cilat BE-ja i ka miratuar në të kaluarën.

I. Përmbushja e qëllimit nga viti 1993

a. Përkufizimet e tregut unik

Me Marrëveshjen e Romës nga viti 1957, me të cilën u themelua Bashkësia Ekonomike Evropiane, u dha mundësia për heqjen e barrierave doganore në kuadër të Bashkësisë dhe për përcaktimin e tarifave të përbashkëta doganore për mallrat që importohen nga vendet që nuk janë anëtare. Ky qëllim u arrit më 1 korrik të vitit 1968.

Por, taksat doganore janë vetëm një aspekt i barrierave proteksioniste të tregtisë tejkuftare. Gjatë viteve '70, barriera të tjera tregtare e vështirësuan funksionimin e plotë të tregut të përbashkët. Normat teknike, standardet shëndetësore dhe të sigurisë, legjislacioni nacional lidhur me të drejtën për kryerjen e profesioneve të caktuara dhe shkëmbimin e kontrollit – të gjitha këto e kufizojnë lëvizjen e lirë të njerëzve, mallrave dhe kapitalit.

b. Qëllimi nga viti 1993

Në qershor të vitit 1985, Komisioni, nën udhëheqjen e kryetarit të atëhershëm Zhak Delor, e publikoi Librin e Bardhë, ku propozohej në shtatë vitet e ardhshme të hiqen të gjitha barrierat fizike, teknike dhe tatimore të lëvizjes së lirë në Bashkësi.

Qëllimi i tij ishte të nxitet rritja industriale dhe tregtare në kuadër të një zone të madhe të bashkuar ekonomike ngjashëm me tregun amerikan.

Instrumenti që mundësoi funksionimin e tregut unik ishte Akti Unik Evropian, që hyri në fuqi në vitin 1987. Dispozitat e tij përfshijnë:

- Zgjerimin e kompetencave të Bashkësisë lidhur me disa politika (politika sociale, hulumtimi, ambienti jetësor);
- Vendosja graduale e tregut unik deri në fund të vitit 1992, me aplikimin e programit voluminoz legjislativ duke përfshirë miratimin e qindra direktivave dhe rregulloreve;
- Përdorimi i shpeshtë i shumicës së kualifikuar në Këshillin e ministrave.

II. Si duket sot tregu unik

a. Barrierat fizike

U hoqën të gjitha kontrollet ndërkufitare për mallrat në suaza të BE-së, bashkë me kontrollin e pasaportave të njerëzve. Kontrollat e rastit nga ana e policisë (të cilat janë pjesë të luftës kundër kriminalitetit dhe trafikut me drogë) ende bëhen kur kjo është e nevojshme.

Marrëveshja e Shengenit, që u nënshkrua nga

ana e një grupi të parë vendesh anëtare në vitin 1985, e pastaj u zgjerua edhe në vendet tjera (me përjashtim të Irlandës dhe Britanisë së Madhe), ka të bëjë me bashkëpunimin policor dhe politikën e përbashkët për azil dhe emigracion, me qëllim që të hiqet kontrolli i personave në kufijtë e brendshëm të BE-së (shih kapitullin 10: "Liria, siguria dhe drejtësia"). Vendet të cilat u bashkëngjitën në vitin 2004 gradualisht i pranuan rregullat e zonës së Shengenit.

b. Barrierat teknike

Për shumicën e prodhimeve, vendet e BE-së e pranuan parimin e njohjes së ndërsjellë për rregullat nacionale. Çdo prodhim i prodhuar në mënyrë legale, i cili tashmë shitet në një vend anëtar, patjetër duhet të lejohet të plasohet në tregjet e të gjitha vendeve tjera anëtare.

Liberalizimi i sektorit të shërbimeve u mundësua duke iu falënderuar njohjes së ndërsjellët ose koordinimit të rregullave nacionale lidhur me qasjen deri te profesionet e caktuara ose aplikimin e tyre (e drejta, mjekësia, turizmi, bankieri, kompanitë e sigurimit etj). Por, liria e lëvizjes nuk është arritur as së afërmi. Akoma ekzistojnë shumë pengesa që i pengojnë njerëzit të lëvizin nga një vend në tjetër të BE-së ose atje të punojnë.

U ndërmorën masa për përmirësimin e lëvizshmërisë së punëtorëve, veçanërisht për diplomat për arsim dhe kualifikime pune (për instalues uji, marangoz etj) të fituara në një nga vendet e BE-së të pranohen në të gjitha vendet tjera.

Hapja e tregjeve nacionale të shërbimeve e uli çmimin e thirrjeve telefonike nacionale, shumë më ulët se që ishte para 10 viteve. Me ndihmën e teknologjisë së re, interneti shfrytëzohet më shumë se sa thirrjet telefonike. Presioni i konkurrencës kontribuoi për uljen e dukshme të çmimeve të biletave të aeroplanit në Evropë.

c. Barrierat tatimore

Barrierat tatimore u zvogëluan nëpërmjet harmonizimit të pjesërishtë të shkallës nacionale të TVSH. Vënia e tatimit të ardhurave nga investimet u rregullua me marrëveshje mes vendeve anëtare dhe disa vendeve tjera (duke përfshirë edhe Zvicrën) që hyri në fuqi në korrik të vitit 2005.

ç. Marrëveshjet në sektorin publik

Pa marrë parasysh nëse tenderët me interes publik jepen nga ana e autoriteteve nacionale, rajonale ose lokale, ato janë të hapur për kandidatët nga cili do vend i BE-së, që është rezultat i direktivave për shërbime, furnizime dhe veprimtari në shumë sektorë, duke përfshirë edhe furnizimin me ujë, energjinë dhe telekomunikacionin.

III. Puna në rrjedhë

a. Shërbimet financiare

Plani i BE-së për krijimin e tregut të integruar për shërbimet financiare deri në vitin 2005 u zbatua tërësisht. Me atë u zvogëluan shpenzimet e huazimeve për biznese dhe konsumues, ndërsa kursimtarëve iu ofrua zgjedhje më të madhe e prodhimeve investuese – plane për kursim dhe skema pensionale – që ata mund t'i marrin nga çdo institucion evropian të cilën vetë e zgjedhin. Gjithashtu janë zvogëlur shpenzimet për pagesa jashtë shtetit.

b. Barrierat administrative dhe teknike mbi lëvizjen e lirë

Vendet e BE-së akoma ngurrojnë të pranojnë standardet dhe normat e ndërsjella, kurse në raste të rralla me mëdyshje pranojnë barasvlerën e kualifikimeve profesionale. Natyra e shkëputur e sistemeve nacionale tatimore vështirëson integrimin dhe efektivitetin e tregut.

c. Pirateritë dhe falsifikimi

Është e nevojshme mbrojtja nga pirateria dhe falsifikimi i prodhimeve të BE-së. Komisioni Evropian vlerësoi se kriminaliteti i tillë e zvogëlon për mijëra numrin e vendeve të punës në BE për çdo vit. Prandaj Komisioni dhe qeveritë nacionale punojnë për forcimin e mbrojtjes së drejtave të autorit dhe patentat.

IV. Politika e cila mbështet tregun unik

a. Komunikacioni

Politika e BE-së para së gjithash ka të bëjë me dhënien e lirë të shërbimeve në komunikacionin rrugor, veçanërisht në qasjen e lirë në tregun ndërkombëtar të komunikacionit dhe të pranimit të ndërmarrjeve të komunikacionit jo rezidente në kuadër të tregjeve nacionale komunikuese në vendet-anëtare. U miratuan vendime për



harmonizimin e konkurrencës në fushën e komunikacionit rrugor, veçanërisht kualifikimet punuese dhe qasja e lirë në treg, dhe për lirinë e krijimit të bizneseve dhe të dhënies së shërbimeve, orarit të vozitjes dhe sigurisë së rrugës.

Politika e përbashkët e komunikacionit ajror duhet të jetë në pajtim me rezultatet e konkurrencës anembanë botës. Qielli mbi Evropën vazhdimisht liberalizohet, që rezulton me ekzistimin e një numri të kapaciteteve mes avio-kompanive të mëdha, qasjen reciproke të tregut dhe lirinë e caktimit të çmimit. Kjo shkon bashkë me klauzolat mbrojtëse me qëllim që të merren parasysh përgjegjësitë e shërbimeve publike ajrore dhe kërkesat për urbanizim.

Komunikacioni ujor – pa dallim nëse kryhet nga ana e ndërmarrjeve evropiane ose nga

fillon që nga Marrëveshja e Romës. Kjo është pasojë e pashmangshme e rregullave për tregti të lirë në kuadër të tregut unik evropian. Komisioni Evropian bashkë me Gjykatën e Drejtësisë janë përgjegjës për zbatimin e kësaj politike.

Arsyeja për këtë politikë është të pengohet lidhja e marrëveshjeve mes bizneseve të veçanta, dhënia e ndihmës nga ana e autoriteteve ose ekzistimi i monopolit jo të drejtë, që mund ta prishin konkurrencën e lirë të tregut unik.

Ndërmarrjet ose institucionet duhet t'ia paraqesin Komisionit çdo marrëveshje të përfshirë në rregullat e Traktatit. Komisioni mund t'i caktoj dënim cilës do ndërmarrje që i ka shkelur rregullat e konkurrencës ose nuk e ka paraqitur atë.

Në rast të ndihmës publike jolegale, ose lëshimin që e ka bërë, Komisioni mund të kërkojë nga ai që e ka pranuar ndihmën ta kthejë të njëjtën. Komisioni duhet të lajmërohet për çdo bashkim ose marrje që mund të rezultojë me pozitë dominuese në ndonjë ndërmarrje në sektor të caktuar.

c. Politika e mbrojtjes së konsumatorëve

Politika e BE-së për mbrojtjen e konsumatorëve u mundëson qytetarëve të saj lirinë për të blerë në cilin do qoftë vend anëtar. Prodhimet që i blejnë dhe ushqimin që e konsumojnë testohet dhe kontrollohet me qëllim që të sigurohet se janë tërësisht të sigurt. BE-ja ndërmerr masa me të cilat jeni të mbrojtur nga tregtarët jo të ndershëm dhe nga reklama jo e saktë dhe e rrejshme. Të drejtat tuaja janë mbrojtur dhe mund të kërkonit kompensim ku do që të gjendeni në BE, pa marrë parasysh nëse blini në shitore, me anë të postës, telefonit dhe internetit.

© Strauss/Curtis/Van Parys Media



Konkurrenca e rritur i uli çmimet e biletave të aeroplanit dhe e lehtësoi udhëtimin.

ana e anijeve me flamur të ndonjë vendi që nuk është anëtar i BE-së – është rregulluar me rregullat e BE-së për konkurrencë. Qëllimi i rregullave është të luftojnë kundër caktimit jo të barabartë të çmimeve (flamuj të cilët ndërrohen sipas nevojës) dhe të ballafaqohen me vështirësitë serioze në ndërtimin e anijeve në Evropë.

b. Konkurrenca

Politika e fuqishme e BE-së për konkurrencë

7. Bashkimi ekonomik dhe monetar (BEM) dhe Euroja





- Euroja është valuta e vetme në Bashkimin Evropian. Në vitin 1999, dymbëdhjetë nga 15 vendet e atëhershme e miratuan euron për transaksionet jo të gatshme, e më vonë në vitin 2002 me vendosjen e bankënotave dhe monedhave, euroja filloi të qarkullojë gjatë pagesës.
- Tre shtete (Danimarka, Suedia dhe Britania e Madhe) nuk janë pjesë e unionit monetar.
- Vendet-anëtare të reja përgatiten që të hynë në euro zonën pasi t'i plotësojnë kushtet e nevojshme.
- Paralelisht me qëllimin për ruajtjen e stabilitetit monetar, që gjendet në kompetencat e Bankës Qendrore Evropiane, vendet anëtare janë të obliguara për rritjen e lartë dhe konvergjencën ekonomike.

I. Historia e bashkëpunimit monetar

a. Sistemi Monetar Evropian (SME)

Në vitin 1971, Shtetet e Bashkuara të Amerikës vendosën ta heqin lidhjen fikse mes dollarit dhe çmimit zyrtar të arit, që e mbante stabilitetin monetar global pas Luftës së Dytë Botërore. Kjo i vuri fundin sistemit të kursit fiks revizor. Me qëllim që të krijonin unionin e vet monetar, vendet e BE-së vendosën ta pengojnë variacionin e kursit devizor nga mbi 2.25% mes valutave evropiane me anë të intervenimit të përbashkët në tregjet revizore.

Kjo rezultoi me krijimin e Sistemit Monetar Evropian (SME) që filloi të funksionojë në mars të vitit 1979. Ai kishte tre karakteristika kryesore:

- valutë referente e quajtur eku: që në të vërtetë paraqiste "shportë" të përbërë nga valutat e të gjitha vendeve-anëtare;
- mekanizëm devizor: secila valutë kishte kurs revizor të lidhur me eku-n; kurset bilaterale revizore mund të fluktuonin në kuadër të 2.25%;
- mekanizëm kreditor: çdo vend transferon 20% nga valuta e saj dhe rezervat në ar në fondin e përbashkët.

b. Nga SME drejt BEM

Sistemi Monetar Evropian ka histori të

bujshme. Pas bashkimit të Gjermanisë dhe presionit të përtërirë devizor në Evropë, lira italiane dhe sterlina e braktisën SME në vitin 1992.

Në gusht të vitit 1993, vendet e SME vendosën t'i rrisin kornizat e fluktuimit në 15%. Ndërkohë, me qëllim që të pengohet fluktuimi i madh devizor mes vendeve të BE-së dhe me qëllim që të shmangen devalvimet konkurruese, qeveritë e BE-së vendosën ta ngjallin idenë për unionin e tërësishëm monetar dhe të vendosin valutë unike.

Në qershor të vitit 1989, në Samitin e Këshillit të Evropës në Madrid, liderët e BE-së miratuan planin për formimin e unionit ekonomik dhe monetar në tre faza. Ky plan ishte pjesë e Marrëveshjes nga Mاستrihti për Bashkimin Evropian të miratuar nga ana e Këshillit Evropian në dhjetor të vitit 1991.

II. Bashkimi Ekonomik dhe Monetar (BEM)

a. Tre fazat

Faza e parë, që filloi në 1 korrik të vitit 1990, përfshinte:

- lëvizja e plotë e lirë e kapitalit në suaza të BE-së (kontrolltet gjatë shkëmbimit u hoqën);
- rritja e vlerës së mjeteve të dedikuara për



© Janez Skok/Corbis

Më 1 janar tregtarët në tregjet në Lubjanë e shkëmbyen tollarin slloven me euron.

mënjanimin e pabarazive mes rajoneve evropiane (Fonde strukturore);

- konvergjenca evropiane, mes mbikëqyrjes multilaterale mbi politikat evropiane të vendeve-anëtare.

Faza e dytë filloi më 1 janar të vitit 1994. Kjo parashihte:

- themelimin e Institutit Monetar Evropian (EMS) në Frankfurt; IME ishte përbërë nga guvernatorët e bankave qendrore të vendeve të BE-së;
- pavarësia e bankave qendrore nacionale;
- rregullat për kontrollin e deficiteve buxhetore nacionale.

Faza e tretë ishte lindja e euros. Më 1 janar të vitit 1999, 11 vende e pranuan euron, që u bë valuta e përbashkët e Austrisë, Belgjikës, Francës, Gjermanisë, Irlandës, Italisë, Luksemburgut, Holandës, Portugalisë dhe Spanjës. (Greqia iu bashkëngjiti më 1 janar të

vitit 2001). Nga ky moment, Banka Qendrore Evropiane e mori përgjegjësinë nga EMS dhe u bë kompetente për politikën monetare, që u definua dhe u zbatua në euro.

Më 1 janar të vitit 2002, bankënotat dhe monedhat filluan të qarkullojnë në këto 12 vende nga euro zona. Valutat nacionale u tërhoqën dy muaj më vonë. Që këtej, euroja u bë valuta unike ligjore për të gjitha transaksionet me të holla të gatshme dhe bankare në vendet e euro zonës, që përfshijnë më shumë se dy të tretat e popullatës së BE-së.

b. Kriteret për konvergjencë

Secili vend i BE-së duhet të plotësojë pesë kriteret për konvergjencë, që të mund të kalojnë në fazën e tretë, e këto janë:

- **stabiliteti i çmimeve:** shkalla e inflacionit nuk guxon ta tejkalojë shkallën mesatare të inflacionit të tre vendeve-anëtare me inflacionin më të ulët për më shumë se 1.5%;



- **shkalla e kamatës:** shkalla afatgjate e kamatës nuk guxon të ndryshojë për më shumë se 2% në krahasim me shkallën mesatare të kamatës të tre vendeve-anëtare me shkallë më të ulët të kamatës;

- **deficiti:** deficiti buxhetor nacional duhet të jetë nën 3% të PBN;

- **borxhi publik:** ai nuk guxon ta tejkalojë shumën e 60% të PBN;

- **stabiliteti i normës shkëmbyese:** kursi devizor duhet të mbetet në kuadër të kufirit të lejuar të fluktuimit për dy vitet e mëparshme.

c. Pakti për stabilitet dhe zhvillim

Në qershor të vitit 1997, Këshilli i Evropës e miratoi Paktin për stabilitet dhe zhvillim, që kishte për detyrë ruajtjen e stabilitetit buxhetor, dhe mundësoi caktimin e dënimeve për vendet nga euro zona buxheti i të cilave do të ishte më i lartë se 3%. Më vonë u vërtetua se Pakti ishte tepër i ashpër dhe u riformua në mars të vitit 2005.

ç. Eurogrupi

Eurogrupi është organ joformal ku takohen ministrat e financave nga euro zona. Qëllimi i këtyre takimeve është të sigurohet koordinimi më i mirë i politikave ekonomike, të vëzhgohen politikat buxhetore dhe financiare të vendeve nga euro zona, si dhe ta paraqesin euron në forumet ndërkombëtare monetare.

d. Vendet e reja anëtare të BEM


Të gjitha vendet e reja anëtare do ta pranojnë euron atëherë kur do t'i plotësojnë kriteret e nevojshme. Sllovenia ishte vendi i parë nga vendet që iu bashkëngjitën me zgjerimin nga viti 2004 dhe u bënë pjesë e euro zonës më 1 janar të vitit 2007.



Euroja: valutë unike e mbi 310 milionë njerëzve në BE.

8. Drejt shoqërisë të bazuar në dituri






Prioritet janë rritja dhe vendet e punës

- Unioni planifikon t'i përgjigjet globalizimit me anë të rritjes së konkurrencës së ekonomisë evropiane (liberalizimi i telekomunikacionit, shërbimeve dhe energjisë).
- Unioni i mbështet programet reformuese të vendeve-anëtare ashtu që e ndihmon shkëmbimin e "praktikave më të mira".
- Unioni angazhohet t'i bashkojë nevojat për rritje dhe konkurrencë me qëllimet për vendosjen e kohezionit social dhe zhvillimit të qëndrueshëm, të cilat janë zemra e modelit evropian.
- Në periudhën buxhetore 2007-13, Fondet strukturore të BE-së do të shfrytëzohen më shumë për trajnime, inovacione teknologjike dhe hulumtime.

Në fillim të viteve '90, dy ndryshime të rëndësishme filluan t'i transformojnë ekonominë dhe jetën e përditshme jo vetëm në Evropë, por në gjithë botën. Njëra është dukuria e ekonomisë globale si rezultat i asaj se ekonominë bëheshin më të varura njëra nga

tjetra. Ndryshimi i dytë ishte revolucioni teknologjik – dukuria e internetit dhe teknologjitë e reja informatike dhe komunikuese.

© IMAGEMORE Co, Ltd/Getty Images



Evropianët duhet të jenë të pajisur për tregun e sotëm të punës.



Pensionistëve të ardhshëm iu nevojitet siguri sociale e cila duhet të krijohet tani.

I. Procesi i Lisbonës

a. Qëllimet

Që në vitin 2000, liderët e BE-së e kishin të qartë se ekonomisë evropiane i nevojitet modernizim i tërësishëm që të mund të garojë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me lojtarët tjerë botërorë. Në takimin e mbajtur në Lisbonë, në mars të vitit të njëjtë, Këshilli i Evropës i parashtroi BE-së qëllim të ri dhe njaft ambicioz: deri në vitin 2010 të bëhet “ekonomia më konkurruese dhe më dinamike në botë, e bazuar në dijeni, e aftë për zhvillim të qëndrueshëm, me më shumë vende pune dhe kohezion më të madh social”.

b. Strategjia

Këshilli i Evropës, gjithashtu arriti pajtim edhe për strategjinë e hollësishme për arritjen e këtij qëllimi. “Strategjia e Lisbonës” përfshin çështje siç janë hulumtimet shkencore, arsimi, trajnimi profesional, qasja te interneti dhe puna mes internetit. Në atë janë përfshirë

edhe reforma e sistemeve evropiane për mbrojtje sociale. Këto sisteme janë ndër instrumentet më të rëndësishme të Evropës: ato u mundësojnë shoqërive tona t’i pranojnë strukturat e domosdoshme dhe ndryshimet sociale pa shumë probleme. Por, ato duhet të modernizohen që të jenë të qëndrueshme dhe që gjeneratat e ardhshme të mund t’i gëzojnë këto të mira.

Çdo pranverë, Këshilli i Evropës mban mbledhje ku shqyrton avancimin e Strategjisë së Lisbonës.

II. Fokus më i madh rritjes së vendeve të punës

Këshilli i Evropës në mbledhjen e vet në pranverë të vitit 2006 nuk u përpoq ta fsheh faktin se pas gjashtë vjet nga shpallja, rezultatet e procesit të Lisbonës edhe më tej mbetën të përziera. Prandaj vendosi të merret me problemin e shkallës së lartë të papunësisë në shumë vende të BE-së dhe të përqendrohet në prioritetet e BE-së drejt rritjes

ekonomike. Nëse dëshiron që ekonomitë e saja të jenë më produktive dhe të rritet kohezioni social, Evropa duhet të vazhdojë me aktivitetet e saja për përmirësimin e aktivitetit ekonomik, inovacioneve teknologjike dhe përsosjen e shkathtësive të popujve të saj.

Prandaj, me iniciativë të kryetarit të Komisionit Evropian, Hoze Manuel Baroso, vendet-anëtare të BE-së vendosën:

- Të investojnë më shumë në hulumtimin dhe inovacionet teknologjike;

- t'ia zgjerojnë rolin koordinatorit të Komisionit Evropian me qëllim t'i jepet mbështetje vendeve-anëtare, veçanërisht nëpërmjet përhapjes së "praktikave më të mira" në Evropë;

- të përshpejtohet reforma e tregjeve financiare dhe e sistemeve të sigurisë sociale dhe të përshpejtohet liberalizimi i sektorit energjetik dhe të telekomunikacionit.



9. Një Evropë e qytetarëve





- Duke iu falënderuar Bashkimit Evropian, qytetarët e vendeve-anëtare mund të udhëtojnë, të jetojnë dhe të punojnë në gjithë Evropën.
- Lidhur me jetën e përditshme, BE-ja i mbështet dhe i financon programet për afrimin e qytetarëve të saj, veçanërisht në fushën e arsimit dhe kulturës.
- Ndjenja e përkatësisë së Bashkimit Evropian do të forcohet gradualisht, nëpërmjet rezultateve konkrete dhe suksesit të arritur.
- Ekzistojnë disa simbole që e paraqesin identitetin e përbashkët evropian. Më e rëndësishmja është valuta e përbashkët, por BE-ja ka flamurin dhe himnin e vet.

I. Të udhëtosh, të jetosh dhe të punosh në Evropë

E drejta e parë e çdo qytetari evropian është e drejta të udhëtojë, të punojë dhe të jetojë kudo në Union. Kjo e drejtë është pjesë përbërëse e Marrëveshjes nga Mاستrihti, më saktë në kapitullin për shtetësinë.

BE-ja e miratoi direktivën me të cilën themelohet sistemi për pranimin e ndërsjellë të arsimit të lartë. Direktiva i përfshinë të gjitha kurset universale që zgjatin më së paku tre vjet, e kjo bazohet në parimin e besimit të ndërsjellë në cilësinë e sistemeve nacionale për arsim dhe trajnim.

Çdo person që është shtetas i ndonjë vendi anëtar të BE-së mund të punojë në fushën e shëndetësisë, arsimit dhe në sektorët tjerë kudo në Union, me përjashtim të aktiviteteve të cilat janë nën kompetenca të jashtëzakonshme të autoriteteve (policisë, forcave të armatosura, punëve të jashtme etj.). A ka diçka më të natyrshme sesa të angazhohet mësues britanik të ligjërojë gjuhën angleze në Romë ose të nxitet ndonjë belg i ri i diplomuar të paraqitet në provimin për punësim në administratën shtetërore në Francë?

Nga viti 2004, qytetarët evropianë që udhëtojnë nëpër BE mund të marrin **kartelë për sigurim shëndetësor** evropian nga autoritetet e veta nacionale, që ndihmon në mbulimin e shpenzimeve mjekësore në rast

të sëmundjes gjatë qëndrimit në ndonjë vend tjetër.

II. Si mund t'i realizojnë qytetarët të drejtat e tyre

Evropianët nuk janë vetëm konsumatorë ose bartës të ndonjë roli ekonomik dhe social. Ata gjithashtu janë shtetas të Bashkimit Evropian dhe si të tillë kanë të drejta specifike politike. Në pajtim me Marrëveshjen nga Mاستrihti, secili shtetas i Unionit – pa marrë parasysh kombësinë – **ka të drejtë të votojë dhe të kandidohet në zgjedhjet lokale në vendet-anëtare ku jeton**, si dhe në zgjedhjet parlamentare evropiane.

Në këtë mënyrë BE-ja u bëhet e afërme qytetarëve të saj. Shtetësia e Unionit është e bazuar në Marrëveshjen ku thuhet se “secili person që ka nënshtetësi të një vendi-anëtar është nënshtetas i Unionit. Nënshtetësia e Unionit është komplementare dhe nuk e zëvendëson nënshtetësinë nacionale”.

III. Të drejtat fundamentale

Marrëveshja nga Amsterdami, që hyri në fuqi në vitin 1999, e forcoi konceptin e të drejtave fundamentale. Marrëveshja parasheh ngritjen e procedurës kundër ndonjë vendi të BE-së që i shkel të drejtat fundamentale qytetare. Marrëveshja gjithashtu e zgjeron parimin e jo diskriminimit, me atë që e mbulon jo vetëm orientimin nacional, por edhe gjinor, racor, religjioz, të moshës dhe seksit.

Së fundi, Marrëveshja e Amsterdami e përmirësoi politikën e BE-së për transparencë, duke u lejuar qytetarëve qasje më të madhe në dokumentet zyrtare të institucioneve evropiane.

Orientimi i Bashkimit Evropian ndaj të drejtave qytetare u konfirmua në Nicë, në dhjetor të vitit 2000, kur u publikua Karta e të drejtave fundamentale të Bashkimit Evropian. Kjo Kartë u përpilua nga Konventa e përbërë nga anëtarë të parlamenteve nacionale dhe nga Parlamenti Evropian, përfaqësues të qeverive nacionale dhe nga një anëtar i Komisionit Evropian. Në gjashtë kapitujt – Dinjiteti, Liritë, Barazitet, Solidariteti, Të Drejtat e Qytetarëve dhe Drejtësia – 54 nenet e saja i definojnë vlerat fundamentale të Bashkimit Evropian dhe të drejtat qytetare, politike, ekonomike dhe sociale të qytetarëve të BE-së.

Nenet e para kanë të bëjnë me dinjitetin njerëzor, të drejtën e jetës, të "integritetit të personalitetit", lirisë së të shprehurit dhe moralit. Kapitulli për "Solidaritetin" përfshinë në mënyrë inovative të drejtat sociale dhe ekonomike, siç janë:

- e drejta për grevë;
- e drejta e punëtorëve të informohen dhe të këshillohen;
- e drejta për jetë familjare dhe profesionale;
- e drejta për kujdes shëndetësor, sigurim social dhe ndihmë sociale në gjithë Bashkimin Evropian.

Gjithashtu Karta promovon barazi mes meshkujve dhe femrave, si dhe parasheh të drejta, siç është mbrojtja e të dhënave, ndalesa për praktikat eugjenike dhe klonimin e qenieve njerëzore, e drejta për mbrojtjen e mjedisit, të drejtat e fëmijëve dhe personave të moshuar, dhe e drejta për administrim të mirë.

IV. Evropa do të thotë arsimim dhe kulturë

Ndjenja e përkatësisë së një bashkësie dhe të një fati nuk mund të "prodhohen". Ato ndjenja mundet vetëm të dalin nga vetëdija e përbashkët kulturore, që tregon se pse tani Evropës i duhet të fokusojë vëmendjen e vet jo vetëm në ekonomi, por edhe në arsimim dhe kulturë.

Programet e BE-së për arsimim dhe trajnim janë vetëm një element. Ato mbështetin programe për shkëmbim studentësh me qëllim të udhëtimit jashtë shtetit, të marrin pjesë në aktivitete shkollore jashtë shtetit dhe të mësojnë gjuhë të reja etj. Ende po vendoset për atë se si janë organizuar shkollat dhe arsimimi në nivel nacional dhe lokal dhe si është programi arsimor.

Në fushën e kulturës, programet e BE-së "Kultura" dhe "Media" janë krijuar me qëllim ta nxitin bashkëpunimin mes krijuesve programorë, promotorëve, transmetuesve dhe artistëve nga vende të ndryshme. Në këtë mënyrë nxitet prodhimi i madh i programeve evropiane televizive dhe filmave me çka vendoset baraspesha mes prodhimtarisë evropiane dhe amerikane.

V. Ombudsmeni dhe e drejta e ankesës

Për të ndihmuar që ta ofrojë BE-në me qytetarët e vet, Marrëveshja për Bashkimin Evropian e parashikoi edhe funksionin e Ombudsmanit. Parlamenti Evropian zgjedh Ombudsmenin dhe mandati i tij është i njëjtë me atë të Parlamentit. Roli i tij është t'ishqyrtojë ankesat kundër institucioneve dhe organeve të BE-së. Ankesat mund të paraqiten nga çdo qytetar i BE-së dhe nga çdo person që jeton ose është vendosur në një shtet të BE-së. Ombudsmeni tenton të arrijë marrëveshje miqësore mes atij që ankohet dhe institucionit apo organit që është i akuzuar.

Lidhje tjetër e rëndësishme mes qytetarëve dhe institucioneve të BE-së është e drejta e çdo qytetari që jeton në ndonjë nga vendeve anëtare t'i dërgojë peticionit Parlamentit Evropian

Programet e BE-së për të mësuarit e përditshëm: vlerësimi për periudhën programore 2007-13.

Lloji i arsimit	Emri i programit të BE	Qëllimet
Arsimi fillor	Komenius	5% nga nxënësit në Bashkimin Evropian do të marrin pjesë në aktivitete të përbashkëta arsimore.
Arsimi i lartë	Erasmus	Tre milionë studentë do të mund të studiojnë në universitetet jashtë vendit të tyre.
Trajnimi profesional	Leonardo da Vinçi	Çdo vit 80.000 persona do të mund të trajnohen në ndërmarrje dhe qendra për trajnime në vende tjera evropiane.
Arsimi për të rriturit	Grundtvig	7.000 njerëz çdo vit do të mund të kryejnë aktivitete arsimore jashtë vendit të tyre.
Studime për integrim evropian	Zhan Mone	Mbështetje hulumtimit akademik dhe ligjërata për integrimet evropiane.



Evropa në 12 leksione

VI. Përfshirja e qytetarëve


Ideja e “Evropës së qytetarëve” është shumë e re. Tashmë ekzistojnë disa simbole që e paraqesin identitetin e përbashkët evropian, siç është pasaporta evropiane (në përdorim që nga viti 1985), himni evropian (“Oda e gëzimit” nga Beethoveni) dhe flamuri evropian (rreth i përbërë nga 12 yje të arta me prapavijë të kaltër). Modeli evropian i lejes për vizitë filloi të aplikohet në të gjitha vendet-anëtare që nga viti 1996. BE ka moton e vet “Të bashkuar në llojlojshmëri”, ndërsa 9 Maji është caktuar si “Dita e Evropës”.

Prej vitit 1979, Parlamenti Evropian është zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me votim të përgjithshëm. Kjo i jep legjitimitet më të madh demokratik procesit të unifikimit evropian, duke e lidhur direkt me vullnetin e popullit. Evropa duhet të bëhet edhe më demokratike duke i dhënë Parlamentit rol më të madh, duke krijuar parti autentike politike evropiane dhe duke u dhënë qytetarëve të thjeshtë rol më të madh në krijimin e politikës së BE-së përmes organizatave qytetare dhe asociacioneve tjera vullnetare.

Vënia në qarkullim e bankënotave dhe monedhave të euros në vitin 2002 pati efekt të madh psikologjik. Sot, më shumë se dy e treta e qytetarëve të BE-së i menaxhojnë buxhetet dhe kursimet e tyre në euro. Faktimi i çmimeve të mallrave dhe shërbimeve në euro u mundëson konsumatorëve krahasim të lehtë të çmimeve nga vendi në vend. Duke iu falënderuar Marrëveshjes së Shengenit (të cilës duhet t’i përmbahen të gjitha vendet e BE-së), kontrollet janë hequr në pjesën më të madhe të kufijve mes shteteve dhe kjo tani u jep qytetarëve një ndjenjë përkatësie në një hapësirë unike gjeografike.

“Ne nuk bashkojmë shtetet, ne bashkojmë popujt”, tha Zhan Mone në vitin 1952. Ngritja e vetëdijes për BE-në dhe inkuadrimi i qytetarëve të saj në aktivitetet e saja është një nga sfidat më të mëdha të institucioneve të BE-së.

10. Liria, siguria
dhe drejtësia





- Hapja e kufijve të brendshëm mes vendeve-anëtare të BE-së është përfitim konkret për njerëzit e thjeshtë, që u mundëson lëvizje të lirë pa kaluar nëpër kontrollet e pasaportave.
- Por, liria e tillë e lëvizjes së brendshme duhet të shkojë barabartë e forcimin e kontrollit të kufijve të jashtëm të BE-së, me qëllim të suksesit kundër trafikut me njerëz dhe drogë, kriminalitetit të organizuar, emigracionit ilegal dhe terrorizmit.
- Vendet e BE-së bashkëpunojnë në fushën e policisë dhe drejtësisë me qëllim që Evropa të jetë më e sigurt.

Qytetarët evropianë kanë të drejtë të jetojnë në liri, pa frikë për të qenë të persekutuar ose t'i nënshtrohen dhunës gjithkund në Bashkimin Evropian. Por, krimi ndërkombëtar dhe terrorizmi janë ndër çështjet që më së shumti i brengosin evropianët sot.

Integrimi në fushën e drejtësisë dhe punët e brendshme nuk ishin përfshirë në Marrëveshjen për themelimin e Bashkësisë Evropiane. Por, siç kalonte koha, u bë e qartë se liria e lëvizjes nënkupton që dikujt t'i japësh mbrojtjen dhe qasjen e njëjtë në drejtësi kudo në BE. Për këtë arsye, fusha e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë gradualisht u zhvilluan nëpër vite, së pari me Aktin Unik Evropian, Marrëveshjen për Bashkimin Evropian (Marrëveshja nga Mاستrihti) dhe Marrëveshja nga Amsterdami.

I. Liria për të lëvizur

Liria personale për të lëvizur brenda BE-së ngre çështje të sigurisë për shtetet anëtare, pasi që kontrollet janë hequr në shumicën e kufijve të brendshëm të BE-së. Për të kompensuar këtë, duhet të vendosen masa plotësuese sigurie në kufijtë e jashtëm të BE-së. Pasi që liria e lëvizjes vlen edhe për kriminelët, forcat policore nacionale dhe autoritetet gjyqësore duhet të punojnë bashkë për të luftuar krimin e organizuar. Një nga hapat më të rëndësishëm që ua lehtësoi jetën udhëtarëve në Bashkimin Evropian ndodhi në vitin 1985, kur qeveritë e Belgjikës, Francës, Gjermanisë, Luksemburgut dhe Holandës nënshkruan marrëveshje në

në qytetin e vogël kufitar të Luksemburgut, Shengen. Ata u pajtuan të heqin të gjitha kontrollet e njerëzve –pa marrë parasysh kombësinë – në kufijtë e tyre të përbashkët, të harmonizojnë kontrollet në kufijtë me shtetet jashtë BE-së dhe të promovojnë një politikë të përbashkët për vizat. Në këtë mënyrë ata formuan zonën pa kufij të brendshëm, e njohur si Zona e Shengenit.

Pakoja e Shengenit dhe ligjet sekondare që dolën nga kjo pako, deri më sot janë pjesë integrale e Marrëveshjeve të BE-së, ndërsa Zona e Shengenit gradualisht po zgjerohet. Deri më vitin 2006, 13 vende të BE-së (Austria, Belgjika, Danimarka, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Italia, Luksemburgu, Holanda, Portugalia, Spanja dhe Suedia) bashkë me Islandën dhe Norvegjinë që nuk janë anëtare të BE-së i implementojnë plotësisht rregullat e Shengenit.

Kur 10 vendet e reja u bashkëngjitën në vitin 2004, kishin afat prej shtatë vjetësh t'i plotësojnë kriteret për anëtarësim në Zonën e Shengenit.

II. Azili dhe politika e emigracionit

Evropa është krenare për traditën e saj të gjatë të mikpritjes dhe gatishmërisë humanitare që ka treguar duke u ofruar azil refugjatëve, që ikin nga rreziku dhe persekutimi. Sot qeveritë e BE-së ballafaqohen me çështjen e rritjes së numrit të emigrantëve legalë dhe ilegalë në një rajon pa kufij të brendshëm.



© IOM

Trafikantët e njerëzve përfitojnë nga personat vulnerabil – është i nevojshëm bashkëpunimi policor ndërkombëtar

Qeveritë e BE-së janë pajtuar t'i harmonizojnë rregullat e tyre, ashtu që kërkesat për azil të procedohen në pajtim me një numër parimesh themelore që janë pranuar njëzëshëm në gjithë Bashkimin Evropian.

Në vitin 1999, ata i parashtruan vetes qëllimin e miratimit të një procedure të përbashkët azili dhe trajtim të njëjtë personave që u është dhënë azil në gjithë Unionin. U miratuan disa masa teknike, siç janë standarde minimale për pranimin e azil-kërkuesve dhe dhënien e statusit të refugjatit.

U formua Fondi Evropian për Refugjatë, buxheti i të cilit ishte 114 milionë euro në vjet. Edhe krahas bashkëpunimit të madh mes qeverive nacionale, akoma mungon politika për azil dhe emigracion në nivel të BE-së.

III. Lufta kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit

Për të hartuar politikën për azil dhe emigracion të qëndrueshëm, BE-ja duhet

të ketë një sistem efikas për menaxhim të emigracionit, përfshirë këtu edhe kontrollet adekuate të kufijve të tij të jashtëm dhe masa adekuate për të ndaluar emigracionin ilegal. Ka nevojë për aktivitete të koordinuara për të luftuar bandat kriminele, të cilat kanë rrjet për trafikim me njerëz dhe të cilët eksploatojnë qeniet njerëzore, veçanërisht gratë dhe fëmijët.

Krimi i organizuar është edhe më i sofistikuar dhe rregullisht shfrytëzon rrjeta evropiane ose ndërkombëtare për aktivitetet e veta. Terrorizmi qartë ka treguar se mund të sulmojë me brutalitet të paparë gjithkund në botë.

Për këtë shkak edhe u formua Sistemi Informativ i Shengenit (SISH). Kjo paraqet një bazë komplekse të të dhënave, që i mundëson policisë dhe autoriteteve gjyqësore të shkëmbejnë informata për njerëzit që kërkohen ose është kërkuar ekstradim, si dhe për pronën e vjedhur, si për shembull automjetin ose veprat artistike.

Një nga mënyrat më të mira të arrestimit të kriminelëve është të ndiqet gjurma e përfitimeve të tyre në mënyrë jolegale. Për këto arsye dhe për ta ndërprerë financimin e këtyre organizatave kriminele, BE-ja e shfrytëzon legjislacionin për të parandaluar pastrimin e parave.

Suksesi më i madh deri më tani në fushën e bashkëpunimit mes nëpunësve që e zbatojnë ligjin, ishte formimi i **Europolit**. Europoli është organ i BE-së, me seli në Hagë, dhe është i përbërë nga policë dhe doganierë. Ky organ merret me spektrin e gjerë të krimit ndërkombëtar: transportin e drogës, tregtinë me vetura të vjedhura, trafikimin e njerëzve, eksploatimin seksual të grave dhe fëmijëve, pornografinë, falsifikimin, trafikimin me materiale radioaktive dhe nukleare, terrorizmin, larjen e parave dhe falsifikimin e eurove.

IV. Drejt “një zone gjyqësore evropiane”

Aktualisht, ka shumë sisteme të ndryshme gjyqësore që funksionojnë paralelisht në Bashkimin Evropian, secili brenda kufijve të shtetit anëtar. Nëse Unioni dëshiron që qytetarët të kenë një koncept të vetëm juridik, atëherë sistemet e tij ligjore duhet ta bëjnë jetën e njerëzve më të lehtë e jo më të rëndë. Shembulli më i rëndësishëm i bashkëpunimit praktik në këtë fushë është puna që bën Eurojust, një strukturë qendrore koordinative, e themeluar në Hagë në vitin 2003. Qëllimi i saj është t’u mundësojë autoriteteve nacionale hetuese dhe të prokurorisë, të punojnë së bashku në hetimet kriminalistike, ku përfshihen disa shtete të BE-së.

Qëllimi i **fletë-arrestit** evropian, që përdoret nga janari i vitit 2004, është t’i zëvendësojë procedurat e gjata për ekstradim.

Krimi ndërkombëtar dhe terrorizmi nuk i njeh kufijtë nacionalë. Kjo do të thotë se është e nevojshme politikë e përbashkët penale të BE-së, pasi që bashkëpunimi mes gjykatave në vende të ndryshme mund të pengohet nga

ana definicioneve të tyre të ndryshme të një akti kriminal të caktuar. BE-ja ka për qëllim të ketë një kornizë të përbashkët ligjore për të luftuar terrorizmin, që do t’u garantojë qytetarëve të vet një nivel më të lartë të mbrojtjes dhe të lëvizë përpara bashkëpunimin në këtë fushë.

Në fushën e të drejtës ndërkombëtare, BE-ja e miratoi legjislacionin me qëllim që të lehtësohet zbatimi i vendimeve gjyqësore në rastet tejkufitare, të cilat kanë të bëjnë me shkurorëzime, ndarjet e pronave, kujdestari dhe kërkesat për mbikëqyrje, që vendimet gjyqësore të mund të vlejnjë në të gjitha vendet. BE-ja solli procedura të përbashkëta për shpejtimin e zgjidhjes së rasteve tejkufitare për kërkesat e vogla qytetare siç është kthimi i huasë dhe bankroti.



11. Bashkimi Evropian në skenën ndërkombëtare





- BE ka ndikim më të madh në skenën botërore kur flet njëzëri në fushën e punëve të jashtme. Shembull i mirë për këtë janë negociatat tregtare.
- Në fushën e mbrojtjes, çdo vend e mban sovranitetin e vet, pa marrë parasysh nëse është anëtare e NATO-s ose është vend neutral. Por, vendet-anëtare të BE-së zhvillojnë bashkëpunim ushtarak lidhur me misionet paqësore.
- Për shkak të afërsisë historike dhe gjeografike, Mesdheu Jugor dhe Afrika janë rajone me interes të veçantë për BE-në (politika për ndihmën e zhvillimit, preferenca tregtare, ndihmë në ushqim dhe të drejtat e njeriut).

Në aspektin ekonomik, tregtar dhe monetar, Bashkimi Evropian paraqet një forcë kryesore botërore. Disa e kanë përshkruar BE-në si gjigant ekonomik, por edhe si shkurtabiq politik. Kjo është e tepruar. Unioni ka ndikim të rëndësishëm brenda organizatave ndërkombëtare, siç është Organizata Tregtare Botërore (OTB), e gjithashtu edhe në organet e Kombeve të Bashkuara (KB), si dhe në samitet botërore për mjedisin jetësor dhe zhvillimin.

Sidoqoftë, është e vërtetë se shtetet anëtare të BE-së kanë shumë për të bërë në aspektin politik dhe diplomatik, para se të mund të flasin njëzëri për çështjet e mëdha, si paqja dhe stabiliteti, marrëdhëniet me SHBA-të, terrorizmi, Lindja e Mesme dhe roli i Këshillit të Sigurimit të KB. Sovraniteti i tyre nacional, me fjalë të tjera sistemet e tyre mbrojtëse, janë në duart e qeverive nacionale dhe lidhjet mes tyre janë ato brenda aleancave, siç është NATO.

I. Një politikë e pazhvilluar e përbashkët mbrojtëse

Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (PPJS) dhe Politika Evropiane për Siguri dhe Mbrojtje (PESM), të parapara me Marrëveshjet nga Mاستrihti (1992), Amsterdami (1997) dhe Nica (2001) i definojnë detyrat kryesore të BE-së në fushën e mbrojtjes. Në bazë të kësaj, BE-ja e ka zhvilluar "shtyllën e dytë" – fushë politike ku për aktivitetet vendoset me anë të marrëveshjeve ndërqeveritare dhe ku Komisioni dhe Parlamenti luajnë vetëm rol të vogël. Vendimet në këtë sferë merren me konsensus, duke lejuar që shtetet-anëtare

anëtare individuale mund të abstenojnë gjatë vendosjes.


a. Relievi politik dhe strategjik në vitin 2006

Lufta e ftohtë që zgjati më shumë se gjysmë shekulli përfundoi – Rusia ka orientim të ri, ndërsa ish vendet komuniste iu bashkëngjitën NATO-s dhe BE-së pothuaj njëkohësisht. Kontinenti i Evropës po bashkohet në mënyrë paqësore, ndërsa shtete evropiane punojnë bashkërisht për të luftuar krimin ndërkombëtar, trafikimin e njerëzve, emigracionin ilegal dhe larjen e parave.

BE-ja e zgjeruar ka vendosur partneritet me fqinjët e tij, mes të cilave ka shtete që kanë perspektivë afatmesme për inkuadrim në Union.

SHBA-të pranuan se për aktivitetet ushtarake ku amerikanët nuk dëshirojnë të kyçen, Evropa mund të përdorë një pjesë të caktuar të kapaciteteve logjistike të NATO-s, siç është kundërzbulimi, komunikimet, komandat dhe mundësitë transportuese.

Dhuna e terrorizmit që e goditi botën pas sulmeve në Nju Jork dhe Uashington më 11 shtator të vitit 2001, si dhe sulmet me bombë në Madrid në vitin 2004 dhe Londër 2005, e kanë ndryshuar rrënjësisht pamjen strategjike. Vendet evropiane duhet të bashkëpunojnë edhe më shumë në zbulimin e informatave që do t'i parandalonin terroristët dhe përkrahësit e tyre për të kryer sulme të tilla. Bashkëpunimi me SHBA-të dhe me shtetet e tjera që e mbështetin demokracinë dhe të drejtat e



Ndihmë gjatë kohërave të vështira – ushtarët e BE-së ndihmojnë në vendosjen e paqes në Kongo.

njeriut tashmë i kalon suazat e aleancave tradicionale mbrojtëse.

b. Rezultatet konkrete në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes

Në pajtim me Marrëveshjen nga Amsterdami, Javier Solana u emërua Përfaqësues i Lartë i BE-së për Politikë të Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (CFSP) në vitin 1999.

Vendet-anëtare të BE-së kanë për qëllim formimin e Politikës Evropiane të Sigurisë dhe të Mbrojtjes. Kjo u bë me qëllim të vendosjes së forcave për reagim të shpejtë me mbështetje detare dhe ujore, dhe të njëjtat të mbështeten për së paku një vit. Këto forca për reagim të shpejtë ende nuk paraqesin ushtrinë e vërtetë evropiane. Përkundrazi, ato janë të përbëra nga kontingjente të forcave ekzistuese të armatosura nacionale.

Megjithatë, me formimin e Komisionit Politik dhe të Sigurisë (PSC), Komisionin Ushtarak të Bashkimit Evropian (EUMC) dhe nga personeli ushtarak i Bashkimit Evropian (EUMS), nën komandën e Këshillit dhe me seli në Bruksel,

Unioni tashmë ka instrument politik dhe ushtarak për të kryer detyra të caktuara: misione humanitare jashtë Evropës, operacione paqësore dhe detyra të tjera për menaxhim me kriza.

Me avancimin dhe rritjen e çmimeve të teknologjisë ushtarake, qeveritë e BE-së mendojnë se është e domosdoshme që ata të bashkëpunojnë në prodhimin e armëve. Gjithashtu, nëse forcat e tyre të armatosura janë pjesë të misioneve të përbashkëta, sistemet e tyre duhet të jenë adekuate dhe pajisja e tyre duhet t'i plotësojë standardet. Këshilli i Evropës në Selanik, në vitin 1993 vendosi për formimin e Agjencisë Evropiane për Mbrojtje.

Që nga viti 2003 BE-ja organizoi disa misione paqësore dhe misione për menaxhim me kriza. Misioni më i rëndësishëm është ai në Bosnjë dhe Hercegovinë ku forcat ushtarake të Bashkimit Evropian (EUFOR), të përbëra nga 7.000 trupa i zëvendësuan forcat paqësore të NATO-s në dhjetor të vitit 2004.

II. Politikë tregtare e hapur ndaj botës

Bashkimi Evropian e mbështeti sistemin e bazuar mbi parime të Organizatës Tregtare Botërore (OTB). Kjo mundëson siguri legale dhe transparencë në udhëheqjen e tregtisë ndërkombëtare. OTB i cakton kushtet, me të cilat anëtarët e veta mund të mbrohen nga padrejtësitë si dampusu (shitja me çmim më të ulët), të cilin eksportuesit e përdorin kundër rivalëve të tyre. OTB, gjithashtu, e cakton procedurën për zgjidhjen e kontesteve që paraqiten mes dy ose më shumë partnerë tregtarë.

Politika tregtare e BE-së është e lidhur ngushtë me sistemin e saj të përgjithshëm të preferencave (SPP), BE-ja u dha vendeve në zhvillim dhe ekonomive në tranzicion qasje preferenciale pa doganë ose me shkallë të ulët në tregun e saj për shumicën e mallrave të importuar. Ajo bën lëshime plotësuese për 49 vendet në të varfra në botë. I gjithë

eksporti i tyre, me përjashtim të armëve, mund të hyjë në tregun e BE-së pa doganë, që është pjesë e programit të filluar në vitin 2001.

Por, BE-ja nuk ka marrëveshje specifike tregtare me partnerët e saj më të mëdhenj mes vendeve të zhvilluara siç janë SHBA-të dhe Japonia. Ato marrëdhënie tregtare rregullohen mes mekanizmave të OTB. SHBA-të dhe Bashkimi Evropian përpiqen të vendosin marrëdhënie mbi barazinë dhe partneritetin. Por, vendet e BE-së nuk pajtohen gjithnjë lidhur me lidhjet diplomatike, politike dhe ushtarake që BE-ja i ka me SHBA-të.

Bashkimi Evropian e ka rritur tregtinë me shtetet më të fuqishme në pjesët tjera të botës, nga Kina dhe India deri në Amerikën Qendrore dhe Jugore. Marrëveshjet tregtare me këto vende përfshijnë edhe bashkëpunim teknik dhe kulturor.



Evropa në 12 leksione



© Reuters

Vera është një ndër prodhimet më të shpeshta të BE-së që eksportohet në SHBA, partneri i saj më i rëndësishëm tregtar

III. Marrëdhëniet mes BE dhe vendeve nga Mesdheu

Duke marrë parasysh afërsinë e tyre gjeografike, lidhjet historike dhe kulturore, si dhe emigracionin, vendet nga bregdeti jugor i Mesdheut janë partnerët më të rëndësishëm të BE-së. Prandaj BE-ja tradicionalisht angazhohet për politikë të integritimit rajonal.

Në nëntor të vitit 1995, BE-ja i vendosi themelet e partneritetit të ri mes Evropës dhe Mesdheut në konferencën në Barcelonë, ku morën pjesë të gjitha vendet-anëtare të BE-së dhe shtetet që kufizohen me Mesdheun (përveç Shqipërisë, Libisë dhe vendeve nga ish Jugosllavia). Kjo konferencë mundësoi që të vendoset forma e partneritetit të ri, përfshirë këtu:

- dialogun politik mes shteteve pjesëmarrëse dhe një partneritet sigurie, të bazuar në veçanti në mekanizmat për kontroll të armëve dhe zgjidhje paqësore të konflikteve;

- avancimi i marrëdhënieve ekonomike dhe tregtare mes dy rajoneve: çelësi për këtë është krijimi i zonës së lirë euro-mesdhetare deri në vitin 2010;

- partneritetet në fushën sociale dhe kulturore.

BE-ja u dha ndihmë financiare vendeve mesdhetare me vlerë 5,3 miliardë euro për periudhën 2000-2006. Në periudhën buxhetore 2007-13, programet paraprake për mbështetje të Mesdheut dhe shteteve tjera fqinje, mes të cilave edhe vendet trashëgimtare të ish Bashkimit Sovjetik, vazhduan të ekzistojnë dhe janë bashkuar në një Instrument Evropian për Fqinjët dhe Partneritet (IEFP).



Qasja në ujë të pijshëm për secilin, është një nga prioritetet e BE-së

IV. Afrika

Marrëdhëniet mes Evropës dhe Afrikës sub-sahariane ekzistojnë që moti. Me Marrëveshjen nga Roma në vitin 1957, kolonitë e mëparshme dhe territoret tej-oqeanike të disa vendeve-anëtare u bënë anëtare të Bashkësisë. Dekolonizimi, që filloi në fillim të viteve '60, kthyen këtë lidhje në një bashkëpunim mes shteteve sovraane.

Marrëveshja nga Kotonu, e nënshkruar në qershor të vitit 2000 në kryeqytetin e Beninit, shënoi një fazë të re të politikës zhvillimore të BE-së. Marrëveshja mes Bashkimit Evropian dhe vendeve afrikane, të Karaibeve dhe atyre të Pacifikut (AKP), është marrëveshja më ambicioze dhe më e gjerë për tregti dhe ndihmë, që është finalizuar mes shteteve të zhvilluara dhe shteteve në zhvillim. Kjo marrëveshje ishte vazhdim i Konventës së Lomes – më parë e nënshkruar në vitin 1975 në kryeqytetin e Togos, dhe vazhdimisht e azhurnuar në intervale të rregullta.

Qëllimi themelor i marrëveshjes mbetet i njëjtë si ai i Konventës nga Lome: “të promovojmë dhe shpëtojmë zhvillimin ekonomik, kulturor dhe social të shteteve të AKP-së dhe të konsolidojë dhe zhvillojë marrëdhëniet e tyre (me Bashkimin Evropian dhe shtetet e tij anëtare) në frymën e solidaritetit dhe interesit reciprok”.

Marrëveshja e re ka spektër më të gjerë nga marrëveshjet tjera, pasi që ajo i zëvendëson marrëdhëniet tregtare me qasje në treg me marrëdhëniet tregtare në kuptim të gjerë. Ajo, gjithashtu, promovon procedura të reja për zgjidhjen e problemit lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut.

Bashkimi Evropian ka akorduar koncesione speciale tregtare për shtetet e pazhvilluara, prej të cilave 39 janë nënshkruar të kësaj Marrëveshje. Duke filluar nga viti 2005, ato praktikisht do të mund të eksportojnë pa doganë çdo lloj prodhimi në BE. Fondi Evropian për Zhvillim i financon programet për mbështetje vendeve nga AKP, duke paguar mes dy dhe tre miliardë në vjet.



12. Cila është ardhmëria e Evropës?





- Integrimi evropian do të vazhdojë në rajonet për të cilat vendet-anëtare mendojnë se janë me interes të madh që të punojnë bashkë në kuadër të kornizës tradicionale të BE-së (lidhur me çështjet e tregtisë, globalizimit, tregut unik, zhvillimit rajonal dhe social, masat për mbështetjen e rritjes së vendeve të punës dhe shumë të tjera.)
- Procesi institucional i azhurnimit të rregullave me të cilat rregullohen marrëdhëniet mes vendeve-anëtare dhe BE-së dhe mes BE-së dhe qytetarëve të saj do të vazhdojë. Çështja e Marrëveshjes së Kushtetutës do të jetë në krye të të gjitha diskutimeve, pa marrë parasysh formën dhe përmbajtjen e tekstit që do të promovohet.

“Do të vijë dita kur të gjithë popujt e këtij kontinenti, pa i humbur cilësitë e tyre dalluese ose individualitetin e tyre të lavdishëm, do të bashkohen në unitet më të madh dhe do të formojnë vëllazërinë evropiane. Do të vijë dita kur nuk do të ketë fushëbeteja tjera – përveç tregut të hapur të ideve. Do të vijë dita kur plumbat dhe bombat do të zëvendësohen me vota”.

Viktor Hygo i ka thënë këto fjalë profetike në vitin 1849, por duhej më shumë se një shekull që ky parashikim utopist të bëhej realitet. Gjatë kësaj kohe, dy luftëra botërore dhe konflikte tjera të panumërta në tokën evropiane shkaktuan miliona viktima. Kishte momente kur të gjitha shpresat dukeshin të humbura. Sot, dekada e parë e shekullit 21 ofron ardhmëri të ndritshme, por kjo Evropës i sjell vështirësi dhe sfida të reja.

Ndodhi zgjerimi më i madh i Unionit. Siç tha një politikan nga shtetet-anëtare: “Evropa përfundimisht arriti ta bashkojë historinë e saj me gjeografinë e saj”. Në të ardhmen Evropa do të vazhdojë të pranojë anëtarë të rinj. Në ndërkohë, liderët e saj – duke dëgjuar me kujdes opinionin publik – do të duhet të vendosin kur caktojnë kufijtë përfundimtarë gjeografikë, politikë dhe kulturorë të Unionit.

Bashkimi Evropian është pakt mes popujve sovranë që kanë vendosur të ndajnë fatin e njëjtë dhe të tërheqin një pjesë të madhe të sovranitetit të tyre. Kjo ka të bëjë me ato aspekte për të cilat qytetarët evropianë më së

së shumti brengosen: paqja, mirëqenia ekonomike dhe fizike, siguria, demokracia pjesëmarrëse, drejtësia dhe solidariteti. Ky pakt është përforcuar dhe i konfirmuar në mbarë Evropën: gjysmë miliardë banorë kanë zgjedhur të jetojnë nën një ligj dhe në pajtim me vlerat tradicionale, që përqendrohen në humanitetin dhe në dinjitetin njerëzor.

Revolucioni teknologjik aktual në mënyrë radikale transformon jetën në botën e industrializuar, duke përfshirë edhe Evropën. Me rëndësi vitale është të kuptohet se kjo krijon sfida të reja që i kalojnë kufijtë tradicionalë. Zhvillimi i qëndrueshëm, trendet e popullatës, dinamika ekonomike, solidariteti social dhe përgjigja etike e avancimit të shkencave në lëmin e jetës janë çështje që duhet të zgjidhen me sukses në nivel nacional. Duhet të mendojmë edhe për gjeneratat e ardhshme.

Sot, procesi i integritit evropian ka ndikim mbi gjithë kontinentin dhe është pjesë e botës që në mënyrë të shpejtë dhe radikale ndryshon dhe të cilit i nevojitet formë e re e stabilitetit. Evropa ndikohet nga ndryshimet e mëdha të kontinenteve tjera, nga marrëdhëniet me botën islame, sëmundjet dhe urinë në Afrikë, tendencat unilaterale në SHBA, rritja enorme e numrit të popullatës në Azi ose revokimi global i industrive dhe vendeve të punës. Evropa nuk duhet të koncentrohet vetëm në zhvillimin e saj, por duhet të përfshihet plotësisht edhe në globalizimin. Bashkimit Evropian i qëndron një rrugë e gjatë që të mund të mund të jetë

unanime dhe se është aktor i sigurt në skenën e politikës dhe diplomacisë globale.

Institucionet e BE-së e kanë vërtetuar vlerën e tyre, por ato duhet t'i përballojnë me numrin në rritje të detyrave që duhet të kryhen në një union, që vazhdimisht zgjerohet. Sa më shumë shtete anëtare që ka BE-ja, më të mëdha bëhen forcat centrifugale që kërcënojnë ta ndajnë atë. Interesat afatshkurta nacionale mundën shumë lehtë të largojnë apo zhvendosin prioritetet afatgjate të Unionit si tërësi. Mu për këtë, çdokush që merr pjesë në këtë aventurë të padëgjuar, duhet të marrë përsipër përgjegjësitë e veta dhe të veprojë ashtu që sistemi institucional i BE-së të vazhdojë të funksionojë në mënyrë efektive. Çdo ndryshim në sistemin e tanishëm duhet të sigurojë se respektohet pluraliteti i Evropës dhe diversiteti i që janë kapitali më i çmueshëm i popujve evropianë. Reformat gjithashtu duhet të fokusohen në procesin e vendimmarrjes. Insistimi në marrëveshjen unanime thjesht do të kishte çuar në paralizim. Sistemi i vetëm që do të funksiononte është sistemi politik dhe juridik, i bazuar në votimin e shumicës dhe me mekanizma kontrolli e balanca të inkuadruara në të.

Kushtetuta, që u aprovua, dhe është lëndë ratifikimi, nga ana e 25 shefave të shteteve ose qeverive, në tetor të vitit 2004 në Romë, u përpoq t'i përgjigjet nevojave nga thjeshtëzimi i marrëveshjeve dhe për ta bërë sistemin e vendimmarrjes të BE-së më transparent. Qytetarët kanë nevojë që të dinë se "kush çfarë bën në Evropë". Vetëm atëherë njerëzit do të përkrahin idenë e integritimit evropian dhe do të ndjehen të motivuar të votojnë në zgjedhjet evropiane. Kushtetuta i definon qartë kompetencat dhe përgjegjësitë e BE-së, vendeve-anëtare dhe autoritetet rajonale. Me atë bëhet e qartë se integritimi evropian bazohet në dy lloje të legjitimitetit: në vullnetin e njerëzve, të shprehur në mënyrë direkte dhe në legjitimitetin e qeverive nacionale, që e paraqesin kornizën brenda së cilës funksionojnë shoqëritë evropiane.

Pa marrë parasysh për çfarë sistemi kushtetues do të përcaktohen vendet e BE-së, në bazë të diskutimeve të tyre, ai duhet të miratohet nga secila prej tyre me anë të votimit parlamentar ose referendumit nacional. Me qëllim që ta lehtësojë debatin, Komisioni Evropian filloi që t'ua afrojë qytetarëve mes Planit D për Demokracinë, Dialogun dhe Debatin.



© Flying Colours/Digital Vision/Getty Images

Evropa – treg i ideve.

Kushtetuta Evropiane



Historia

Në dhjetor të vitit 2001, Këshilli Evropian formoi Konventën, me qëllim që t'u përgjigjet sfidave të shumta, me të cilat përballet Bashkimi Evropian pas zgjerimit në Evropën Qendrore dhe Lindore. Qëllimi i kësaj Konvente ishte të përpilojë propozim Marrëveshjen e Kushtetutës.

Konventa, e cila e zbatoi detyrën e saj gjatë viteve 2002 dhe 2003, nën udhëheqjen e Valeri Zhiskar d-Esten, që përbëhej nga 105 anëtarë, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e qeverive të vendeve-anëtare dhe të vendeve-kandidate, anëtarët e parlamenteve nacionale, anëtarët e Parlamentit Evropian dhe anëtarët e Komisionit Evropian.

Konventa e miratoi propozim Marrëveshjen me konsensus në qershor të vitit 2003.

Marrëveshja u nënshkrua më 29 tetor 2004 në Romë, e pastaj iu dërgua për ratifikim vendeve-anëtare.

Pjesa më e madhe e vendeve-anëtare e ratifikuan Marrëveshjen, por ajo u refuzua nga Franca dhe Holanda, në maj dhe qershor të vitit 2005. Pas këtyre votave "kundër", Këshilli i Evropës shpalli një periudhë për të menduar për ardhmërinë e Marrëveshjes për Kushtetutën, në samitin që u mbajt më vonë në muajin qershor.

Dispozitat kryesore të Kushtetutës

- Zgjedhja e kryetarit të Këshillit të Evropës me shumicë të kualifikuar me mandat prej dy vjet e gjysmë, që mund të rizgjidhet vetëm një herë.
- Zgjedhja e kryetarit të Komisionit me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të Parlamentit Evropian, me propozim të Këshillit të Evropës duke "marrë parasysh zgjedhjet parlamentare evropiane".
- Vendosja e funksionit Ministër i Punëve të Jashtme të BE.
- Inkuadrimi i plotë i Kartës për të drejtat fundamentale në Marrëveshjen për BE.
- Rritja e numrit të fushave që do të përfshiheshin me shumicën e kualifikuar të votave në Këshillin e Evropës.
- Kompetenca më të mëdha për Parlamentin Evropian në sferën e legjislacionit dhe buxhetit.
- Prezantim më i qartë i ndarjeve të kompetencave dhe përgjegjësiwe mes Unionit dhe vendeve-anëtare.
- Parlamenteve nacionale t'u jepet roli i kontrollit nëse BE-ja e respekton parimin e subvencionimit.

Datat kyçe në historinë e integritit evropian



1950

9 maj

Ministri francez i Punëve të Jashtme, Robert Shuman, mban një fjalim të rëndësishëm, duke ofruar propozime të bazuara në idetë e Zhan Monesë. Ai propozon që Franca dhe Republika Federale e Gjermanisë të bashkojnë rezervat e veta të thëngjillit dhe çelikut në një organizatë, në të cilën mund të bashkëngjiten shtetet tjera evropiane.

Pasi që kjo datë mund të llogaritet si ditëlindja e Bashkimit Evropian, tani 9 maji festohet çdo vjet si “Dita e Evropës”.

1951

18 prill

Në Paris gjashtë shtete - Belgjika, Republika Federale e Gjermanisë, Franca, Italia, Luksemburgu dhe Holanda – e nënshkruan Marrëveshjen, me të cilin themelohet Bashkësia Evropiane për Thëngjill dhe Çelik (ECSC). Hyn në fuqi më 23 korrik, 1952, për periudhë prej 50 viteve.

1955

1-2 qershor

Në takimin në Mesina, Ministrat e punëve të jashtme të gjashtë shteteve vendosin të zgjerojnë integrimin evropian në gjitha sferat ekonomike.

1957

25 mars

Në Romë gjashtë shtetet nënshkruajnë Marrëveshjet që themelojnë Bashkësinë Ekonomike Evropiane (BEE) dhe Bashkësinë Evropiane për Energji Atomike (Euratom). Ato hynë në fuqi më 1 janar të vitit 1958.

1960

4 janar

Me insistim të Britanisë së Madhe, Konventa e Stokholmit formon Asociacionin Evropian të Tregtisë së Lirë (EFTA), të përbërë nga një numër shtetesh evropiane që nuk janë pjesë e BEE.

1963

20 korrik

Në Jaunde, nënshkruhet marrëveshje bashkëpunimi mes BEE dhe 18 shteteve afrikane.

1965

8 prill

Nënshkruhet Marrëveshja që bashkon trupat ekzekutive të tre bashkësive dhe krijon Këshill dhe Komision unik. Hyn në fuqi më 1 korrik të vitit 1967.

1966

29 janar

“Kompromisi i Luksemburgut”. Pas një krize politike, Franca pranon të marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit me kusht që rregulli i unanimitetit të mbetet në fuqi, nëse bëhet fjalë për “interesa vitale nacionale”.

1968

1 korrik

Të dhënat doganore për mallrat industriale hiqen plotësisht, 18 muaj para afatit dhe prezantohet Tarifa e Përbashkët e Jashtme.

1969

1-2 dhjetor

Në Samitin e Hagës, liderët politikë të BEE vendosin të vazhdojnë me integrimin evropian, duke hapur rrugën për zgjerimin e parë.

1970

22 prill

Në Luksemburg nënshkruhet Marrëveshja që u lejon Bashkësive Evropiane të financohen vazhdimisht nga “resurset e veta” dhe t’i jepen kompetenca më të mëdha Parlamentit Evropian.

1972

22 janar

Në Bruksel nënshkruhen marrëveshjet për pranim në Bashkësitë Evropiane me Danimarkën, Irlandën, Norvegjinë dhe Britaninë e Madhe.

1973

1 janar

Danimarka, Irlanda dhe Britania e Madhe u bashkëngjiten Komuniteteve Evropiane, tani ka nëntë shtete anëtare. Pas një referendumi në të cilin shumica e qytetarëve votuan kundër anëtarësisë, Norvegjia mbetet jashtë bashkësive.



Evropa në 12 leksione

1974

9-10 dhjetor

Në Samitin e Parisit, liderët politikë të nëntë shteteve anëtare vendosin të takohen tre herë në vjet, si Këshilli Evropian. Ato gjithashtu japin leje për zgjedhje direkte për Parlamentin Evropian dhe vendosin të formojnë Fondin Evropian për Zhvillim Rajonal.

1975

28 shkurt

Në Lomé, nënshkruhet konventa (Lomé I) mes BEE dhe 46 shteteve të Afrikës, Karibeve dhe Pacifikut (ACP).

22 korrik

Nënshkruhet marrëveshja që i jep Parlamentit Evropian kompetenca më të mëdha mbi buxhetin dhe me të cilin themelohet Gjykata Evropiane e Auditorëve. Hyn në fuqi më 1 korrik 1977.

1979

7-10 qershor

Zgjedhjet e para direkte për 410 vende në Parlamentin Evropian.

1981

1 janar

Greqia i bashkëngjitet Bashkësive Evropiane, duke rritur numrin e shteteve anëtare në dhjetë.

1984

14-17 qershor

Zgjedhjet e dyta direkte për Parlamentin Evropian.

1985

7 janar

Zhak Delor emërohet Kryetar i Komisionit (1985-1995).

14 qershor

Nënshkruhet Marrëveshja e Shengenit, me qëllim që të hiqen kontrollat e pasaportave në kufijtë mes vendeve-anëtare të Bashkësive Evropiane.

1986

7 janar

Spanja dhe Portugalia u bashkëngjiten Bashkësive Evropiane, me çka numri i vendeve-anëtare u rrit në 12.

17 dhe 28 shkurt

Në Luksemburg dhe në Hagë nënshkruhet Akti Unik Evropian. Hyn në fuqi më 1 korrik të vitit 1987.

1989

15 dhe 18 qershor

Mbahen zgjedhjet e treta direkte për Parlamentin Evropian.

9 nëntor

Prëzohet Muri i Berlinit.

1990

3 tetor

Ribashkohet Gjermania.

1991

9-10 dhjetor

Këshilli Evropian në Samitin e Mاستrihtit aprovon Marrëveshjen për Bashkimin Evropian, me çka vendosen themelet për politikë të përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, bashkëpunim më të afërt në sferën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme, si dhe diskuton krijimin e unionit ekonomik dhe monetar, përfshirë valutën unike.

1992

7 shkurt

Në Mاستriht nënshkruhet Marrëveshja për Bashkimin Evropian. Hyn në fuqi më 1 nëntor 1993.

1993

1 janar

Formohet Tregu Unik.

1994

9 dhe 12 qershor

Zgjedhjet e katërta direkte për Parlamentin Evropian.

1995

1 janar

Austria, Finlanda dhe Suedia i bashkëngjiten BE-së, që tani ka 15 anëtarë. Pas një

referendumi ku shumica e qytetarëve votuan kundër anëtarësisë, Norvegjia përsëri mbetet jashtë.

23 janar

Fillon me punë Komisioni i ri Evropian (1995-1999), në krye me kryetarin Zhak Santer.

27-28 nëntor

Konferenca Euro-Mesdhetare në Barcelonë vendos partneritet mes BE-së dhe shteteve në bregun jugor të Mesdheut.

1997

2 tetor

Nënshkruhet Marrëveshja e Amsterdimit. Hyn në fuqi më 1 maj të vitit 1999.

1998

30 mars

Fillon procesi i pranimit për shtetet e reja kandidate. Në këtë proces do të përfshihen Qiproja, Malta dhe dhjetë shtete të Evropës Qendrore dhe Lindore.

1999

1 janar

Fillim i fazës së tretë të EMU: valutat e 11 shteteve të BE-së zëvendësohen nga euroja, që fillon të qarkullojë në tregjet financiare, duke i zëvendësuar valutat e tyre gjatë transaksioneve me të holla jo të gatshme. Nga ky moment, Banka Qendrore Evropiane (ECB) mban përgjegjësinë për politikën monetare. Greqia i bashkëngjitet 11 shteteve në vitin 2001.

10 dhe 13 qershor

Zgjedhjet e pesta direkte për Parlamentin Evropian.

15 shtator


Komisioni i ri Evropian fillon me punë (1999-2004), ku për kryetar emërohet Romano Prodi.

15-16 tetor

Këshilli Evropian në Tampere vendos ta bëjë BE-në një zonë të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë.



Evropa në 12 leksione



© Reuters

Valuta e re lindi në vitin 1999, kur euroja u vendos në pagesat financiare (pagesa me të holla jo të gatshme). Bankënotat dhe monedhat u paraqitën në vitin 2002

2000

23-24 mars

Këshilli Evropian në Lisbonë harton strategji për të nxitur punësimin në BE, duke modernizuar ekonominë dhe sforcuar kohezionin social në një Evropë të bazuar në dije.

7-8 dhjetor

Në Nicë Këshilli Evropian arrin marrëveshje për tekstin e Marrëveshjes së re, me të cilën ndërrohet sistemi vendimmarrës i BE-së, me qëllim që Unioni të jetë i gatshëm për zgjerim. Kryetari i Parlamentit Evropian, Këshillit Evropian dhe Komisionit Evropian solemnisht shpallin Kartën e BE-së për të Drejtat Fundamentale.

2001

26 shkurt

Nënshkruhet Marrëveshja e Nicës. Hyn në fuqi më 1 shkurt 2003.

14-15 dhjetor

Këshilli Evropian në Leken miraton një deklaratë për ardhmërinë e Unionit. Kjo hap rrugën për reformën e madhe të BE-së dhe për formimin e një konvente që do të hartojë kushtetutën evropiane.

2002

1 janar

Në 12 vendet e euro hapësirës fillon të përdoren bankënotat dhe monedhat e euros.

13 dhjetor

Këshilli Evropian në Kopenhagë vendos që dhjetë nga shtetet candidate (Qiproja, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Polonia, Sllovakia dhe Sllovenia) mund t'i bashkëngjiten BE-së më 1 maj të vitit 2004.

2003

10 korrik

Konventa për të Ardhmen e Evropës përfundon punën e saj mbi kushtetutën evropiane.

4 tetor

Fillim i konferencës ndërqeveritare, që do të përpilojë marrëveshje të re, ku do të përfshihet edhe kushtetuta evropiane.

2004

1 maj

Qiproja, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Polonia, Sllovakia dhe Sllovenia i bashkëngjiten BE-së.

10 dhe 13 qershor

Zgjedhjet e gjashta direkte për Parlamentin Evropian.

29 tetor

Miratohet Kushtetuta evropiane në Romë (lëndë e ratifikimit nga ana e vendeve-anëtare).

22 nëntor

Komisioni i ri Evropian fillon me punë në krye me kryetarin Zhoze Manuel Baroso.

2005

29 maj dhe 1 qershor

Votuesit në Francë gjatë referendumit u deklaruan kundër Kushtetutës, tre ditë më vonë deklarohen kundër edhe votuesit në Holandë.

3 tetor

Fillojnë negociatat me Turqinë dhe Kroacinë.

2007

Bullgaria dhe Rumania i bashkëngjiten Bashkimit Evropian. Sllovenia e pranon euron.

Bashkimi Evropian



Komisioni Evropian

Evropa në 12 leksione
Nga Paskal Fonten

Luksemburg: Zyra për botime zyrtare të Bashkësive Evropiane

978-92-79-09690-7

Çfarë qëllimi ka ekzistimi i BE-së? Çfarë ka bërë për qytetarët e saj dhe me cilat sfida ballafaqohet sot? Si mund të inkuadrohen qytetarët më shumë?

Në kohën e globalizimit, a mund BE-ja t'u konkurrojë ekonomive tjera më të mëdha dhe njëkohësisht ta mbajë standardin e vet social? A mund Evropa ta ruajë rolin e liderit në skenën botërore dhe të ndihmojë në luftën kundër terrorizmit?

Këto janë vetëm disa pyetje që Paskal Fonten – ekspert për BE-në dhe profesor i mëparshëm Universitar – i hulumton në botimin e ri të vitit 2007 doracakun e njohur “Evropa në 12 leksione”.

Informata të tjera mbi Bashkimin Evropian



Hapeni internetin

Informatat në të gjitha gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian mund t'i gjeni në faqen e internetit Evropa: europa.eu



Ejani dhe na vizitoni

Në Evropë ka disa qendra qendra informative të BE-së. Adresën e qendrës më të afërt mund ta gjeni përmes faqes: europa.eu.int/comm./relays/index_en.htm



Paraqituni ose na shkruani

EUROPE DIRECT është shërbim që përgjigjet në pyetjet tuaja mbi Bashkimin Evropian. Këtë Këtë shërbim mund ta kontaktoni përmes telefonit pa pagesë: 00 800 6 7 8 9 10 11, (telefoni me pagesë në raste të thirrjeve jashtë BE-së: (32-2) 29-99696), ose me anë të postës elektronike europedirect.europa.eu

Informata dhe broshura mbi BE-në mund të merrni në adresën vijuese:

Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë

Rr. Kosova 1, Fahu postar 331

Prishtinë, Kosovë

Tel. +381 38 5131 200

Faks. :+381 38 5131 305

Web: www.delprn.ec.europa.eu

E-mail: ec-liaison-office-kosovo@ec.europa.eu

Evropa në 12 leksione

Çfarë qëllimi ka ekzistimi i BE-së? Çfarë ka bërë për qytetarët e saj dhe me cilat sfida ballafaqohet sot? Si mund të inkuadrohen qytetarët më shumë?

Në kohën e globalizimit, a mund BE-ja t'u konkurrojë ekonomive tjera më të mëdha dhe njëkohësisht ta mbajë standardin e vet social? A mund Evropa ta ruajë rolin e liderit në skenën botërore dhe të ndihmojë në luftën kundër terrorizmit?

Këto janë vetëm disa pyetje që Paskal Fonten – ekspert për BE-në dhe profesor i mëparshëm Universitar – i hulumton në botimin e ri të vitit 2007 doracakun e njohur “Evropa në 12 leksione”.



NI-80-08-433-SQ-C